

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7862 E enjte 25 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga SKENDER MINXHOZI

Nuk ke ku shkon pa folur me "armikun"!



Nuk ka kompromis dhe dialog me Edi Ramën. Largimi i Edi Ramës është kusht i panegociueshëm i Partisë Demokratike dhe i opozitës së bashkuar". Me këto fjalë ...

Vijon në faqen 20

Opinion

Ditës

Nga DOMINIQUE MOISI

Emocioni i Notre Dame



Njerëzit këndonin, luteshin dhe qanin, ose thjesht ngrinë në një mosbesim total, ndërsa flakët përfshinë katedralen "e tyre" të Notre Dame, objekt ...

Vijon në faqen 21



Kush është 31-vjeçarja, pjesë e grupit

Grabitja në Rinas, rrëfëhet i penduari. Ish-policia në kërkim, dogji furgonin në Kamëz

Alkond Bengasi tregon takimin me Admir Muratajn: Makinën që modifikova ma dhanë vëllezërit Çala

TIRANË - Në megagrabitjen e 9 prillit në aeroportin "Nënë Tereza" të Rinasit dyshohet të ketë marrë pjesë dhe një femër. Bëhej fjalë për 31-vjeçaren E. Bici, e cila dyshohet të ketë djegur furgonin e tretë në afërsi të Bathores. E reja është ende e dyshuar dhe po hetohet në gjendje të lirë. Ndërkohë, sipas burimeve të TV "Klan", femra e vetme që dyshohet të ketë ...

Në faqet 6-7

QEVERIA U NJEH PRONESINE E TRUALLIT PRONAREVE NE TE GJITHE VENDIN

NDERTIMET PA LEJE, LISTA: TAPITE PER 1 MIJE FAMILJE

Emrat e përfituesve në Tiranë dhe në rrethe, sipërfaqja që merr çdo familje. Kalimi i pronësisë për sipërfaqe sa 3-fishi i ndërtimit, por jo më shumë se 500 metra katrorë



(Në foto) Ndërtime informale në Tiranë

Në faqet 13-16

QARKULLIMI



Opozita blokon sot 5 akse rrugore në të gjithë vendin, Basha te "Shqiponja"

Në faqen 3

Pakti mes universitetit dhe Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

"Luarasi", marrëveshje kundër diskriminimit

Et'hem Ruka: Edukim brezave me frymë tjetër. Robert Gajda: Bashkëpunim efektiv

NGA VOLTIZA DURO

Diskriminimi i ushtruar në forma nga më të ndryshmet është ende një problem i mprehtë në shoqërinë tonë. Një nga mënyrat më efektive për mbrojtjen nga ky fenomen është arsimimi dhe edukimi cilësor i brezave të



rinj. Lidhur me këtë kauzë të rëndësishme, universiteti "Luarasi" ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Thelbi i marrëveshjes synon prekjejen nga afër të realitetit ...

Në faqen 9

TAKIMI NE TIRANE

Gramoz Ruçi pret zv.presidentin e PE, Castaldo: Shqipërinë e duam të parën e klasës

Në faqen 4

"30 QERSHORI"

4 orë mbledhje kryesie, PS: Në zgjedhje hyjmë me opozitën e re

Në faqen 12

PJESA E DYTE

Eksperti Stefan Qirici: Edukimi ekonomik, çelësi i suksesit të shoqërisë

Në faqet 10-11

HEROINA NGA IRANI

Arrestohet banda e shqiptarëve në Greqi, sekuestrohen 3 milionë euro drogë

Në faqen 12

PROTESTA OPOZITA

Kërkesa në gjykatë, sot seanca për regjistrimin e partisë "Bindja Demokratike"

"Të rrëzojmë partitokracinë", Patozi: Voto për "bindjen" tënde!

"Momenti që secili prej nesh të marrë një vendim"

Valentina Madani

Pas kërkesës së depozituar në gjykatë, sot në orën 14:00 do të zhvillohet seanca për regjistrimin e Partisë më të re "Bindja Demokratike". Ditën e martë "Bindja Demokratike" dorëzoi në gjykatë kërkesën për regjistrim me katër mijë firma. Partia që koordinatohet nga Astrit Patozi, ish-nënkryetar i Partisë Demokratike, do të garojë në zgjedhjet e 30 qershorit. Ditën e martë, Fabjan Topallaj regjistroi në Komisionin Qendror Zgjedhor aplikimin e BD-së për t'u bërë pjesë e zgjedhjeve. Arbër Skënderi, Valbona Mezini, Fabion Topallaj, Astrit Patozi, Andi Përmeti dhe Leonard Olli, janë anëtarët e mandatuar për kohësisht, deri në zgjedhjen e forumeve drejtuese sipas statutit të partisë. Mes tyre është edhe Andi Përmeti, i cili një javë më parë mori mandatin e deputetit nga KQZ, si kandidat në listat e Partisë Demokratike në zgjedhjet parlamentare të 2017-ës në qarkun e Korçës, pasi opozita dogji në bllok mandatet.

THIRRJA
Pas zyrtarizimit të Partisë "Bindja Demokratike", Astrit Patozi ka nisur "fushatën", duke u bërë thirrje qytetarëve që të votojnë për bindjen e tyre. Pasi i dha jetë formacionit më të ri politik "Bindja Demokratike", koordinatori i kësaj partie, Astrit Patozi, po tenton të tërheqë pas vetes qytetarët. Në një postim në "Facebook", Patozi teksa falënderon të gjithë mbështetësit në këtë start, shkruan se koha do të tregojë shumë shpejt se bëri gjënë e duhur në një kohë të vështirë për vendin. Patozi thekson se ka ardhur momenti që secili prej nesh të marrë një vendim për të dhënë një kontribut që ta rrëzojmë partitokracinë. Patozi thekson në "Facebook" se ka marrë mbështetjen e mijëra burrave dhe grave nga e gjithë Shqipëria, që sipas tij nënshkruan në kohë rekord për krijimin e partisë së re. Kreu i "Bindjes Demokratike" shton më tej se duhet rrëzuar partitokracia, sepse sipas tij, ajo ushqen korrupsionin, abuzimin me pushtetin dhe pabarazinë para ligjit. "Koha do të tregojë shumë shpejt se ne bëmë gjënë e duhur në një



Astrit Patozi, koordinatori i "Bindja Demokratike"

DEKLARATA

"Ka ardhur momenti që secili prej nesh duhet të marrë një vendim për të dhënë një kontribut që ta rrëzojmë partitokracinë, sepse ajo ushqen autoritarizmin, korrupsionin, abuzimin me pushtetin, padrejtësinë dhe pabarazinë e frikshme para ligjit. Është pikërisht koha që çdo shtypar duhet të marrë këtë ftesë: Voto për 'Bindjen' tënde!", shprehet z.Patozi.

"Opozita e bashkuar është kundër keqeverisjes"

Kryemadhi mbledh drejtuesit e rretheve: Në terren me qytetarët

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, apeli strukturat e partisë së saj që të jenë sa më pranë qytetarëve. Ajo zhvilloi dje një takim me kryetarët e LSI-së të rretheve, para të cilëve u shpreh: "LSI është angazhuar në aksionin opozitar dhe do të jetë sa më pranë qytetarëve". Sipas Kryemadhit, "opozita e bashkuar është kundër keqeverisjes, varfërisë dhe largimit të rinjve nga vendi". Kryemadhi përmendi se "lufta kundër varfërisë është prioriteti kryesor". Ajo kërkoi nga strukturat e LSI-së që të jenë të gjithë në terren, në komunikim të drejtpërdrejtë me qytetarët. "LSI është e angazhuar në ak-



sionin opozitar. LSI, sa më pranë qytetarëve. Opozita e bashkuar kundër keqeverisjes, varfërisë dhe largimit të rinjve nga vendi. Lufta kundër varfërisë është prioriteti kryesor. Të gjithë në terren, në komunikim të drejtpërdrejtë me qytetarët", - theksoi kryetarja e LSI-së. Pas nëntë protestave përpara Kryeministrit dhe Kuvendit,

opozita do të bllokoi sot pasditë për një orë 5 akset kryesore që lidhin jugun dhe veriun me kryeqytetin për të paralizuar qarkullimin. Ky është një skenar i përsëritur nga opozita, pasi edhe më parë ka bllokuar rrugët, ndërsa në 11 maj do të jetë protesta kombëtare para Kryeministrit.

kohë të vështirë për vendin, pasi krijuam 'Bindjen' se ishte çasti që të merrnim të gjitha përgjegjësitë tona. Por deri atëherë, ne do të rendim me shpejtësi, duke fuar të na bashkohet çdo qytetar që kërkon ndryshimin e kësaj

gjendjeje dëshpëruese në Shqipëri, për shkak të sistemit dhe qeverisjes së gabuar. Ka ardhur momenti që secili prej nesh duhet të marrë një vendim për të dhënë një kontribut që ta rrëzojmë partitokracinë, sepse ajo ushqen

autoritarizmin, korrupsionin, abuzimin me pushtetin, padrejtësinë dhe pabarazinë e frikshme para ligjit. Është pikërisht koha që çdo shtypar duhet të marrë këtë ftesë: Voto për 'Bindjen' tënde!", - thekson z.Patozi.



Kreu i PD-së, gjatë protestës së 24 prillit 2017 te 'Shqiponja'



Kushtet e opozitës, Biberaj: Gjithçka është e negociueshme

Anëtar i Këshillit Kombëtar të PD-së, Aleksander Biberaj, paralajmëroi dje përshkallëzimin e protestave të opozitës deri në rrëzimin e Edi Ramës nga pushteti. Lidhur me marrjen pjesë të opozitës në zgjedhje, ai tha: "Gjithçka është e negociueshme me maxhorancën, por natyrisht opozita është në aksionin e vet dhe nuk ka për t'u ndalur. Nëse plotësohen kushtet e vendosura nga ana e opozitës, mund të marrim pjesë në zgjedhjet lokale, në të kundërt jo". Ndërkohë që aksioni opozitar do të vazhdojë me protesta, tashmë do të bllokohen akset rrugore. "Kryeministri dhe maxhoranca e kanë topin në fushën e vet aktualisht, por nëse flasim për mënyrat, ka modalitete dhe ka raste e mundësi plot, por duhet që të gjendet gjuha e përbashkët mes qeverisë dhe opozitës jashtë Kuvendit", tha z.Biberaj. Ai foli edhe për strategjinë mëtejshme të opozitës: "Strategjia është e qartë, do të shkohet në zgjedhje të parakohshme, sepse ajo maxhorancë nuk është normale".



Krizë, Rudina Hajdari thirrje qeverisë: Dialog me opozitën

Kryetarja e grupit parlamentar të opozitës së re në Kuvend, Rudina Hajdari, një ditë pas përfundimit të afatit për regjistrimin në zgjedhjet lokale të 30 qershorit i bëri thirrje mazhorancës qeverisëse që të ulet e të dialogojë me opozitën. Ajo shprehet se ata që duan të ardhmen e Shqipërisë duhet të gjejnë zgjidhjen e shumëpritur, duke bërë faktore qeverinë për situatën e krijuar nga uria e saj për pushtet. "Marrëveshjen ndërmjet partive politike të opozitës për mospjesë-marrje në zgjedhjet lokale e shikoj si një fatalitet politik. Nga ana tjetër, indiferenca e qeverisë për situatën e krijuar dhe uria absolute e saj për të gllabëruar çdo ditë pushtet nuk përbën gjë tjetër, veçse shkakun e drejtpërdrejtë të kësaj gjendjeje. Sa nuk është vonë, të gjithë ata që duan të ardhmen e Shqipërisë, nuk duhet të qëndrojnë indiferentë, por të ulen në tryezën e bisedimit për të gjetur zgjidhjen e shumëpritur", shprehet Hajdari.



Basha te rrethrotullimi i 'Shqiponjës', si do të shpërndahen ish-deputetët

Opozita përshkallëzon protestat, sot bllokun 5 akse kombëtare

Një orë bllokim i qarkullimit në disa qytete

Valentina Madani

Opozita e bashkuar do ta zhvendosë sot protestën e saj në akset kryesore që lidhin Jugun dhe Veriun me kryeqytetin. Opozita përgjatë një ore do të shpërndahet në 5 akse rrugore kryesore për të bllokuar lëvizjen e automjeteve për rreth 60 minuta në shenjë proteste. Në vijim të përshkallëzimit të aksionit të saj politik, opozita do të bllokojë pasditen e së enjtes akset kryesore që lidhin jugun dhe veriun me kryeqytetin, duke paralizuar qarkullimin e automjeteve. Ndryshe nga protestat e kaluara përpara Kuvendit, ora 18:00 sot do t'i gjëjë drejtuesit e opozitës dhe ish-deputetët e saj në 5 kryqëzime duke i prirë në protestë qytetarët. Vetë kryetari i PD Lulzim Basha, do t'i bashkohet protestuesve në kryeqytet. Në Tiranë, protestuesit e shoqëruar nga Lulzim Basha do të bllokojnë për të paktën një orë lëvizjen në rrethrotullimin e sheshit "Shqiponja". Protestuesit e Elbasanit dhe juglindjes do të bllokojnë lëvizjen e automjeteve në rrethrotullimin e Bradasheshit. Ndërsa në Durrës, ish-deputetët e opozitës dhe protestuesit do të tubojnë në autostradën Plepa-Kavajë, përballë shtëpisë së pushimit të ushtrisë. Protestuesit e veriut do të bllokojnë lëvizjen e automjeteve në kryqëzimin e Milotit. Ndërsa në jug, mbështetësit e opozitës do të bashkohen në rrethrotullimin e Sheqit. Kjo nuk është hera e parë që opozita nis mosbindjen civile. Nën kryetari i Partisë Demokratike, Edmond Spaho paralajmëroi dy ditë më parë përshkallëzimin të protestave nga opozita, duke filluar nga kjo e enjte. Spaho u shpreh se opozita nuk bojkoton zgjedhjet, por kërkon kushte për mbajtjen e tyre. "Qëndrimi ynë po vjen duke u përshkallëzuar. Opozita është sot mazhoranca reale. Përshkallëzuar qëndrimin tonë këto ditë, duke deklaruar se nuk regjistrohemi në zgjedhje për sa kohë të realizohen kushtet. Ne nuk jemi kundër mbajtjes së zgjedhjeve vendore. Ne do të ishim të gatshëm të hynim në çdo palë zgjedhje pa Edi Ramën. Por zgjedhjet e 30 qershorit tashmë janë dje-



Një nga protestat e PD-së

SKENARI

Protesta e opozitës do të mbahet pasditen e së enjtes në orën 18:00, ndërsa qytetarët do të vendosen për të bllokuar lëvizjen përkatësisht në rrethrotullimin e Bradasheshit në Elbasan, autostradën Plepa-Kavajë në Durrës, kryqëzimin e Milotit në Lezhë, rrethrotullimin e Sheqit në Fier, dhe rrethrotullimin e 'Shqiponjës' në Tiranë.

gur, nuk ka më kohë për t'u mbajtur. Ne nuk po bojkotojmë, por duam kushte për mbajtjen e zgjedhjeve. Ne do të vazhdojmë me protesta dhe ato do të përshkallëzohen. Duke filluar nga e enjta do të fillojmë me bllokimin e rrugëve, akseve kombëtare në të gjithë vendin për një periudhë kohe të caktuar, një orë. Më vonë, do të rritet edhe koha e bllokimit", tha z.Spaho. Ky skenar është i përsëri-

tur pasi më shumë se një vit më parë Partia Demokratike, paralizoi qarkullimin pothuajse në gjithë vendin duke mbajtur të bllokuar akset rrugore kombëtare. Për organizimin e protestës dhe monitorimin e saj, kryetari i PD Lulzim Basha, krahas strukturave qendrore ka urdhëruar ish-deputetët dhe kryetarët e degëve, të cilëve ju ka kërkuar edhe pjesëmarrje të lartë. Për mes

kësaj forme të mosbindjes civile të përdorur edhe më parë, opozita synon të forcojë mesazhin se aksioni i saj do të përshkallëzohet nëse kushti i saj për qeveri tranzitore dhe zgjedhje pa Edi Ramën kryeministër nuk plotësohet. Bllokimi i rrugëve do i paraprëjë protesta simbolike e të rinjve të FRPD-së, e cila rikthehet tek Parlamenti në të njëjtën orë me seancën plenare.

PROTESTA, AKSET QE BLOKON SOT OPOZITA

- 1- Elbasan (Rrethrotullimit Bradashesh).
- 2- Durrës (Autostrada Plepa - Kavajë, përballë Shtëpisë së Pushimit të Ushtrisë).
- 3- Milot (Karburanti në Autostradë).
- 4- Fier (Rrethrotullimi i Sheqit).
- 5- Tiranë (Rrethrotullimi 'Shqiponjës').

EMRAT, SI DO SHPËRNDAHEN ISH-DEPUTETËT NË 5 AKSET RRUGORE

TIRANË- RRETHROTULLIMI 'SHQIPONJA'

- ALDO BUMÇI
- ALBANA ÇOKSHI
- HALIM KOSOVA
- GENT STRAZIMIRI
- KLEVIS BALLIU
- AGRON SHEHAJ
- GRIDA DUMA
- JORIDA TABAKU
- GENC POLLO
- DHURATA ÇUPI
- VALENTINA DUKA
- ASTRIT VELIAJ
- ISUF ÇELA
- FATBARDHA KADIU
- Durrës-AUTOSTRADA PLEPA-KAVAJË
- EDI PALOKA
- OERD BYLYKBASHI
- ORJOLA PAMPURI
- FLORION MIMA
- ELBASAN-RRETHROTULLIMI BRADASHESH
- EDMOND SPAHO
- ENDRI HASA
- LUÇIANO BOÇI
- ERVIN SALIANJI
- HEKURAN HOXHALLI
- FIER- RRETHROTULLIMI I SHEQIT
- ENKELEJD ALIBEAJ
- NADA MEÇORAPAJ
- TRITAN SHEHU
- MILOT-KARBURANTI NË AUTOSTRADË
- FLAMUR NOKA
- LORENC LUKA
- BARDH SPAHIA
- IZMIRA ULQINAKU
- ROMEO GURAKUQI
- XHEMAL GJUNKSHI
- LINDITA METALIAJ

Nuk u regjistruan në zgjedhje, Soreca takon sot aleatët e Bashës

BE përmes ambasadorit të saj në Tiranë, Luigj Soreca po tenton zgjidhjen e krizës politike. Në zyrën e delegacionit të BE në Tiranë sot në orën 16:00 partitë e vogla opozitare do të zhvillojnë një takim me ambasadorin e Bashkimit Europian Luigj Soreca. Ky takim vjen fill pas atij të zhvilluar nga ky grupim, me kreun e misionit të OSBE-së në Tiranë Bernd Borchard dhe ka të njëjtin qëllim. Takimi i kërkuar nga vetë partitë e vogla opozitare, me inicues Partinë Republikane të Fatmir Mediu, synon vendosjen e diskutimit dhe informimin për situatën ku vendi ndodhet, jo vetëm pas djegies së mandateve të deputetëve të opozitës, por edhe pas skadimit të afatit zyrtar për regjistrim në



zgjedhje të partive politike Në takim me ambasadorin Soreca do marrin pjesë krerët e LZHK, PAA, PBDNJ, PDK dhe PR. Këto parti u bënë pjesë e koalicionit opozitar të mërkurën (23 prill), dita kur KQZ mbylli afatin për regjistrimin e partive, që do të jenë pjesë në zgjedhjet vendore të 30 qershorit. Përfaqësia e PD-së nënshkroi paktin me 10 pika fillimisht me republikanët e kryesuar nga Fatmir Mediu, më pas me Agron

Dukën e PAA, Vangelj Dulen e PBDNJ, Nard Ndoçën e PD, Dashamir Shehi të LZHK, Shpëtim Idrizin e PDIU dhe në fund me Monika Kryemadhën e LSI. Në marrëveshje nënvizohet se partitë nënshkruese të këtij koalicioni do të regjistrohen në zgjedhje vetëm pasi të jenë krijuar kushtet për zgjedhje të lira dhe të ndershme. E për këtë rruga e vetme shihet formimi i një qeverie tranzitore me mandat të posaçëm.

KUVENDI INTEGRIMI

Kreu i Kuvendit priti në një takim të veçantë zv.presidentin e PE-së, Fabio Castaldo

Negociatat, Ruçi: Vendimi negativ do të ishte dekurajues për vendin

"Shqipërinë e duam të parën e klasës dhe në krye të listës"

Shqipëria i ka kryer detyrat e saja që i ngarkon procesi i integrimit dhe pret që në qershor t'i hapen negociatat e anëtarësimit të plotë në BE. Ky ishte mesazhi që përcolli dje kryetari i Kuvendit Gramoz Ruçi gjatë takimit që zhvilloi me zëvendës-presidentin e Parlamentit Europian dhe kryetarin e Komisionit për Punët e Jashtme, Fabio Massimo Castaldo. Kryetari i Kuvendit i shprehu zëvendës-presidentit Castaldo mirënjohjen e vlerësimin për ndihmën dhe mbështetjen që Parlamentit Europian, dhe Italia i kanë dhënë Shqipërisë për nxitjen e perspektivës së integrimit evropian dhe për reformat gjithëpërfshirëse e transformuese që ka ndërmarrë. "Mbështetja për hapjen formale të bisedimeve të anëtarësimit të Shqipërisë, në Këshillin e qershorit 2019, mbetet një rëndësi të madhe për ne. Shqipëria është plotësisht e vetëdijshme për sfidat e brendshme me të cilat ballafaqohet BE, të cilat pa ndihim kanë ndikuar edhe te politika e zgjerimit. Shqipëria i ka bërë të gjitha "detyrat e shtëpisë" për plotësimin e standardeve në pesë prioritetet kyçe", u shpreh kryetari i Kuvendit Gramoz Ruçi në fjalën e tij. Më tej ai theksoi se vendimi pozitiv i Këshillit në qershor 2019 do të ishte një moment vendimtar për të treguar gatishmërinë e BE-së për të ruajtur dhe forcuar perspektivën evropiane të Shqipërisë, ndërsa nënvizoi faktin se një vendim negativ do të dekurajonte shumë Shqipërinë si në reformat që ka ndërmarrë ashtu edhe për të ardhmen e saj evropiane. "Unë mendoj se Shqipëria, por edhe vetë BE, ka nevojë që vlerësimet pozitive të shumicës dërmuese të vendeve anëtare të mos errësohen dhe zhvlerësohen nga paragjykimet e veçanta dhe interesat e brendshme elektorale të forcave politike që nuk e kanë aq për zemër as zgjerimin e BE-së, as vetë BE-në. Një vendim negativ në qershor 2019 do të ngadalësonte procesin e integrimit të Shqipërisë dhe do të përcillte një mesazh dekurajues për vendin, shoqërinë dhe popullin tonë. Ngadalësimi i procesit mund të krijojë hapësira që mund të shfrytëzohen nga aktorë të jashtëm që synojnë të rrisin ndikimin e tyre politik, ekonomik dhe kulturor në rajon", - nënvizoi gjatë takimit Kryetari i Kuvendit Gramoz Ruçi. Zëvendës-presidenti i Parlamentit Europian falënderoi Kryetarin e Kuvendit Gramoz Ruçi, për pritjen, ndërsa shprehu

bindjen se me integrimin e Shqipërisë BE bëhet më e fortë dhe më e mirë. "Unë, ashtu si edhe Ju, mendoj se BE bëhet më e fortë me një Ballkan Perëndimor të inte-

guar dhe po përpiqem që këtë qasje ta krijoj edhe për ato vende, të cilat për momentin mund të kenë mendime të ndryshme. Ne nuk duhet t'i lemë aktorët glo-

bale jo dhe kundër evropianë të penetronjë në Ballkanin Perëndimor dhe të devijojnë perspektivën evropiane të rajonit. Ne po luftojmë fort që në qershor

të hapen negociatat dhe Shqipërinë e duam të parën e klasës dhe në krye të listës", - tha Castaldo. Më tej ai shprehu shqetësimin për qëndrimin e opozitës, duke theksuar se qëndrime të tilla dëmtojnë harmoninë politike. "Jam shumë i preokupuar nga qëndrimi i opozitës ndaj parlamentit dhe zgjedhjeve lokale, sepse këto qëndrime dëmtojnë kohezionin politik brenda vendit. Megjithatë, pavarësisht këtyre qëndrimeve, Italia që është vendi im, po lobon fort për hapjen e negociatave në qershor. Ne nuk duhet të zhgënjemi dhe dekurajojmë shqiptarët, por të njohim e vlerësojmë përpjekjet e Shqipërisë për reformat integruuese, sidomos reformat e vështirë dhe unike në drejtësi. Kam qenë dhe do të jem personalisht dhe institucionalisht, si italian dhe evropian, për hapjen e negociatave me Shqipërinë në qershor 2019", - nënvizoi gjatë takimit Castaldo.



Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, gjatë takimit me zv.presidentin e Parlamentit Europian, Fabio Massimo Castaldo

OPOZITA

"Jam shumë i preokupuar nga qëndrimi i opozitës ndaj parlamentit dhe zgjedhjeve lokale, sepse këto qëndrime dëmtojnë kohezionin politik brenda vendit. Megjithatë, pavarësisht këtyre qëndrimeve, Italia që është vendi im, po lobon fort për hapjen e negociatave në qershor. Ne nuk duhet të zhgënjemi dhe dekurajojmë shqiptarët, por të njohim e vlerësojmë përpjekjet e Shqipërisë për reformat integruuese, sidomos reformat e vështirë dhe unike në drejtësi".

Shqipëria task-forcë për njohjen e pavarësisë së Kosovës

Shqipëria ka ngritur një task-forcë për të mbrojtur njohjet e pavarësisë së Kosovës nëpër botë. Lajmin e dha vet ministri i Jashtëm, Gent Cakaj, i cili u shpreh se në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Jashtme të Kosovës dhe me diplomatët më të mirë shqiptarë do të ngrihet një trupë e veçantë diplomatike për të punuar për eliminimin e përpjekjeve që po bën Serbia për tërheqjen e njohjeve të pavarësisë së Kosovës. "Për ne është e papranueshme fushata e Serbisë për tërheqjen e njohjeve të pavarësisë së Kosovës dhe Shqipëria do të ngriejë një task-forcë të veçantë për të adresuar këtë problem. Ministria do të ngriejë task-focën për formimin e pozicionit ndërkombëtar të Kosovës me diplomatët më të kualifikuar nga Kosova dhe Shqipëria. Do të procedohet shumë shpejt me marrëveshje ndërminstrore me 4 komponentë", - tha Cakaj.

Rama: Drejtojuni platformës, të largojmë parazitët nga administrata

Më shumë se 600 nëpunës shtetëror janë pushuar ose kanë marrë masë për mos kryerjen si duhet të detyrës së ngarkuar. Këto shifra i dha kryeministri, Edi Rama dje gjatë takimit të përjavshëm të "Platformës së bashkëqeverisjes me qytetarët". Duke marrë shkas nga rastet e suksesit të sjella nga qytetarët në këtë takim, kreu i qeverisë theksoi deri në këto momente janë ndëshkuar mbi 600 individë, të cilët sipas tij, kanë neglizhuar shërbimin ndaj qytetarëve. "Shumë njerëz që janë në vijën e parë me qytetarët sillen në mënyrë të padenjë dhe një nga vlerat e këtij procesi është ky, që rasti pasi trajtohet dhe zgjidhen vazhdon një hetim për vonesat dhe personat përgjegjës marrin ndëshkimin e duhur. Janë mbi 600 individë, që nga nëpunës të nivelit të zyrave



të kontakteve me qytetarët e deri tek drejtuesit janë larguar, sepse nuk kanë qenë të denjë për shërbimin ndaj qytetarëve", - tha kryeministri, Edi Rama. Ndaj ai ftoi qytetarët që t'i drejtohen platformës me qëllim që të denoncohen grabitqarët dhe parazitët, që nuk i shërbejnë shqetësimeve dhe halleve të tyre. "Falë platformës, zërin tuaj sot e çoni në kryeministri. Sot ju dhe asnjë qytetar nuk është më viktimë. Zëri i qytetarit sot ka vlerë dhe dëg-

johet. Është qeveria miku më i madh i çdo qytetari. Nuk ka mik më të madh dhe më efikas se qeveria, pasi ajo mund ta bëjë për secilin qytetar. Grabitqarët dhe parazitët nuk mund t'i identifikojmë pa ndihmën tuaj. Është koha që të ndajmë të thatin nga i njomi. Më vjen mirë të them se numri total i ankesave në platformë, ka kaluar 41 mijë dhe po afrohen në 30 mijë rastet e zgjidhura", - tha Rama.



Meta takon senatorin italian: Marrëdhënie të forta ekonomike

Presidenti Ilir Meta priti dje senatorin italian dhe përfaqësuesin e partisë "Lega", z.Manuel Vescovi, i cili është edhe anëtar i Grupit të Miqësisë Itali-Shqiptare në Komunitetin italian. Presidenti Meta theksoi se marrëdhëniet historike mes dy vendeve dhe popujve tanë duhen të forcohen edhe më tej në të ardhmen, veçanërisht në planin ekonomik, me fokus rritjen e investimeve italiane në Shqipëri. Presidenti u shpreh i lumtur për rolin në rritje të Komunitetit shqiptar në Itali, që veç të tjerave e tregon edhe kandidimi i përfaqësuesve të spikatur të tij në zgjedhjet e ardhshme evropiane për forcat kryesore politike. Senatori Vescovi e siguroi z.Meta për angazhimin e tij në forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve mes Italisë dhe Shqipërisë në të gjitha fushat e bashkëpunimit. Po dje, presidenti priti një grup nga Arbanasit e Zarisë (Zadardit) në Kroaci, të cilët ndodhen për një vizitë disa ditore në Shqipëri. Presidenti vlerësoi kontributin që komuniteti shqiptar në Kroaci ka dhënë dhe vazhdon të japë për forcimin e marrëdhënieve të shkëlqyera historike, kulturore, politike dhe njerëzore mes dy popujve dhe vendeve tona. "Ende i kam të gjalla ato përshtypje të shkëlqyera nga mikpritja juaj në Zadar. Ka qenë një vizitë e mrekullueshme për mua, por edhe për Presidentin e Kroacisë, Kolinda Grabar-Kitarović?, të cilën e falënderoj edhe njëherë për praninë e saj në atë vizitë", - tha Meta.



Pas 4 orë diskutimesh, socialistët nisin punën për organizimin në terren

PS injoron bojkotin, kryesia: Në zgjedhje, me opozitën tjetër

Në mbledhje është diskutuar edhe për kandidatët

Një ditë pasi opozita vendosi të mos bëhet pjesë e zgjedhjeve të ardhshme vendore pa larguar më parë kryeministri Edi Rama, Partia Socialiste ka mbledhur kryesinë për të diskutuar pikërisht për këtë realitet të ri politik, por edhe hapat që do të ndjekë më tej për zgjedhje vendore. Ndryshe nga herët e tjera, mbledhja e kryesisë nuk është mbajtur në ambientet e PS-së, por në një nga sallat e katit të dytë të Pallatit të Kongreseve. Mbledhja ka zgjatuar më shumë se 4 orë dhe burime pranë saj kanë bërë të ditur se diskutimet u përqendruan pikërisht te hapat që duhet të hedhë më tej mazhoranca, tashmë që opozita ka vendosur të mos hyjë në zgjedhje. Kështu mësohet se edhe një herë Rama ka këmbëngulur se mazhoranca e votuar nga shqiptarët nuk mund të diktohet në qëndrimet e saj nga opozita. Ndaj, ai ka bërë të qartë se PS-ja duhet të shkojë në zgjedhje dhe të kujdeset që të përmbushen të gjitha detyrimet për zgjedhje të lira dhe të ndershme. Kështu, kryesia ka vendosur që të vijojë përgatitjet për zgjedhjet me përzgjedhjen e kandidatëve për kryetar bashkie edhe në ato bashki, ku deri më tani kandidatët nuk janë përcaktuar ende.



Zëdhënësja e Kryesisë së PS-së, Elisa Spiropali

KOALICIONI
"Ne nuk do shkojmë në zgjedhje pa opozitën. Ato nuk janë opozita e vendit, janë disa parti që kanë vendosur të mos jenë më në sistem. Atë vendim e kanë marrë prej frikës dhe arsytet e tyre, edhe për arsyet tona. Janë 42 parti politike që janë regjistruar, disa do jenë në koalicion me ne, disa në koalicionin përballë".

VELIAJ

"E shoh ndoshta si episodin më qesharak të historisë së Shqipërisë. Kur të shkruhet, do të jetë të pjesa komike e çuditave shqiptare. Konica ka shkruar gjatë, 100 vite kalojnë dhe prapë Konica do të kishte material për të shkruar", - tha kryetari i Bashkisë së Tiranës. Gjithsesi, ai shprehet se nuk e shqetëson fakti që përballë në garën për Tiranën do të mungojë një kandidaturë serioze që të përfaqësojë opozitën e vërtetë. "Unë nuk zgjedh dot kush do të jetë kundër meje, ky është një treg i lirë. Unë jam përgjegjës për logon e PS-së që të jetë e përfaqësuar në zgjedhje, nëse dikush tjetër nuk vjen në atë ditë, është humbja e tyre", - u shpreh Veliaj.



LIBRA do të marrë pjesë në zgjedhje, Blushi jo kryetar i saj

Lista e Barabartë", e themeluar nga Ben Blushi do të jetë pjesë e zgjedhjeve, por ajo nuk do të ketë një kryetar që do të shënohet në fletën e votimit, që do përdoret për zgjedhjet lokale të 30 qershorit. Kjo, pasi Ben Blushi ka dhënë më parë dorëheqjen nga posti i kryetarit, ndërkohë që çështja e këtij posti të lënë vakant është bërë objekt i një procesi gjyqësor. Sekretari organizativ i kësaj partie, Gjergji Prifti tha se LIBRA drejtohet nga një bërthamë individësh, duke nënvizuar se Endri Tafani që krijoi debat në KQZ për pozicionin e drejtuesit të LIBRA-s, nuk është kryetar i kësaj force politike. "Pas dorëheqjes së kryetarit, i cili për arsye ligjore dha dorëheqjen, drejtimin e partisë e mori bërthama, që është organi më i lartë i partisë. U krijua një grup brenda bërthamës, që do të procedojë me punën. Gjykata mori një vendim ku i dha të drejtë LIBRA-s, pra Tafani nuk është kryetar i LIBRA-s", - tha Prifti. Ai nuk përjashtoi mundësinë e krijimit të një koalicioni në votimet e 30 qershorit. "Pa diskutim që LIBRA do të marrë pjesë në zgjedhje. LIBRA është një forcë politike e krijuar për të marrë pjesë në zgjedhje, për t'u testuar nga populli shqiptar, do apo jo ndryshimin në politikën 28-vjeçare, që vazhdon të jetë në ato ritmet e vjetra", - tha ai.

Damian Gjijnuri i PS dhe Korab Lita, bashkëkryetarë

Ndryshon formula, opozita e re bëhet pjesë e reformës zgjedhore

Mazhoranca qeverisëse dhe opozita e re parlamentare kanë gjetur gjuhën e përbashkët që të vijojnë punën për reformën në drejtësi. Shumica qeverisëse ka pranuar dje që të ndryshojë sërish vendimin për ngritjen e Komisionit të Reformës Zgjedhore, duke ndryshuar përbërjen e tij dhe objektin e punës. Kështu, Komisioni i Reformës Zgjedhore do të përbëhet tashmë nga 10 anëtarë, nga të cilët 5 do të ketë shumica qeverisëse dhe 5 të tjera, opozita parlamentare. PS-ja do të përfaqësohet në këtë komision me Damian Gjijnurin në pozicionin e bashkëkryetarit, Bashkim Finon në pozicionin e bashkëkryetarit, Klodilda Ferhatin, Belirina Gjylmetin dhe Alket Hysenin. Ndërkohë që opozita e re, ose të dyja grupet e reja parlamentare të krijuara vetëm javën e shkuar do të përfaqësohen nga Korab Lita në pozicionin e bashkëkryetarit të komisionit, si dhe nga Rudina Hajdari, Andi Përmeti, Ralf Gjoni dhe Nimet Musai. Gjithashtu, përveç përbërjes, palët kanë rënë dakord që të ndryshojnë edhe objektin e punës së këtij komisioni. Ato kanë rënë dakord që të përfshihen si pikë e objektit të punës së ko-



pet e reja parlamentare të krijuara vetëm javën e shkuar do të përfaqësohen nga Korab Lita në pozicionin e bashkëkryetarit të komisionit, si dhe nga Rudina Hajdari, Andi Përmeti, Ralf Gjoni dhe Nimet Musai. Gjithashtu, përveç përbërjes, palët kanë rënë dakord që të ndryshojnë edhe objektin e punës së këtij komisioni. Ato kanë rënë dakord që të përfshihen si pikë e objektit të punës së ko-

misionit edhe nisja e diskutimit për rëndësinë e sistemit zgjedhor në vend. Kjo është një kërkesë e vazhdueshme e opozitës së re, e cila pretendon se pikërisht sistemi aktual zgjedhor dhe ndryshimet kushtetuese që e ligëruan atë shumë vite më parë janë e keqja e situatës politike në të cilën ndodhet vendi. Deputetët e rinj kanë kërkuar ose një sistem të pastër mazhoritar, ose një sistem proporcional kombëtar me lista të hapura. Gjithashtu, përfaqësuesit e opozitës së re kanë kërkuar që komisioni të fokusohet edhe te masat e shtesa ligjore kundër shpëllimeve të votës, transparencës financiare dhe mospërdorimit i administratës dhe aseteve publike në zgjedhje.

nuk janë opozita e vendit, janë disa parti që kanë vendosur të mos jenë më në sistem. Atë vendim e kanë marrë prej frikës dhe arsytet e tyre dhe për arsyet tona. Janë 42 parti politike që janë regjistruar, disa do të jenë në koalicion me ne, disa në koalicionin përballë. Ne nuk do të marrim pjesë në luftë, do të marrim pjesë në zgjedhje

dhe asnjë forcë politike nuk mund të ndalojë shqiptarët që të votojnë. Ne mendojmë se shqiptarët duhet të kenë zgjedhje. Ne nuk jemi këtu për të negociuar. Ne jemi një forcë politike, që i përgjigjemi kërkesës për t'u zgjedhur", - tha Spiropali. Më tej, ajo u shpreh se askush nuk mund t'i ndalojë shqiptarët që të votojnë.

Shitje me Ankand të Pare nga Studio Permbartimorë L.D.C
- Nr. pasurisë 50/1, ZK Virua, vol 1, fq.27, Trrall me sip. 240.47 m² + ndërtesa me sip. 240.47 m². Regjistruar në ZVRPP Gjrokaster në emër të Fatos Çela. Çmimi fillestar për shitje është 3.445.600 Leka.
- Nr. pasurisë 190/84, ZK 2647, vol 2, fq.247, Trrall me sip. 300 m² + ndërtesa një katëshe me sip. 88 m². Regjistruar në ZVRPP Tepelene në emër të Votim Çela. Çmimi fillestar për shitje është 1.064.000 Leka.
Data e shpalljes 09.04.2019
Data e zhvillimit 08.05.2019 deri në orën 16.00
Ankandi zhvillohet në ambientet e Studios Permbartimorë L.D.C me adresë Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tiranë.

Shitje me Ankand të Dytë nga Studio Permbartimorë L.D.C
"Trrall" me sip. 1,874m² nga e cila 250 m² është ndërtesa, me Nr. Pasurisë 134/33, vol. 25, faqe 62, ZK 2436 e ndodhur në Levan, Fier. Regjistruar në Z. R. P. P. Fier në emër të Shoq. Albjon shpk. Çmimi fillestar për shitje është 6.180.854 Leka.
Data e shpalljes 02.04.2019
Data e zhvillimit 07.05.2019 deri në orën 16.00
Ankandi zhvillohet në ambientet e Studios Permbartimorë L.D.C me adresë Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tiranë.

NJOFTIM ANKANDI
1. Shoqëria e Përbartimit "BALIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k njofton Shpalljen e Ankandit të I (Pare), për shitjen e pasurisë së paluajtshme : Garazh, me sip. 96 m², Zona Kadastrale: 2640, Numri i Pasurisë: 199/32-G3, Vol. 45, Faqe 169, ndodhur në Lincë Dajç, Tiranë, në pronësi të Shoqërisë "AGL" shpk identifikuar me NIFIT 17170200MM. Ankandi i pasurisë fillo me çmimin fillestar në vlerën 1,893,120 (një milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e njëzet) LEKË.
Ankandi do të zhvillohet më datë 26.04.2019, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përbartimit "BALIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k, në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 131, Ap.1, Tiranë, nr.telëfon 042320227, email: shviti@hotmail.com.
Ankandi të publikohet nga data 22.04.2019 deri më 26.04.2019

GRABITJA NE RINAS

DESHMIA

Prokuroria: Dyshohet se ka pasur rol kryesor, bëri lëvizjen e parave

Megagrabitja në aeroportin e Rinasit, zbulohet identiteti i ish-polices

31-vjeçarja dyshohet se dogji furgonin e tretë në Kamëz për të shpërqendruar policinë

TIRANË Në megagrabitjen e 9 prillit në aeroportin "Nënë Tereza" të Rinasit dyshohet të ketë marrë pjesë dhe një femër. Bëhej fjalë për 31-vjeçarën E. Bici, e cila dyshohet të ketë djegur furgonin e tretë në afërsi të Bathores. E reja është ende e dyshuar dhe po hetohet në gjendje të lirë. Ndërkohë, sipas burimeve të TV Klan, femra e vetme që dyshohet të ketë marrë pjesë në grabitjen spektakolare ka qenë punonjëse e Policisë së Shtetit në vitin 2015 dhe është larguar nga policia me dëshirën e saj. 31-vjeçarja, sipas burimeve nga Prokuroria për Krimet e Rënda, ka pasur rol të rëndësishëm në grabitje. Ajo dyshohet se është personi që ka bërë lëvizjen e parave nga makina, më të cilën u larguan grabitësit për në një vend tjetër. Shuma e parave, sipas hetuesve, besohet se është ende në zonën e Niklës. Ish-policia besohet gjithashtu, se është personi që ka djegur makinën në Bathore, për të shpërqendruar aksionin e policisë. Për ndalimin e saj është duke u zhvilluar një

aksion në Tiranë. E. Bici, në bazë të informacioneve të mbledhura, dyshohet se është njëkohje e vjetër e Admir Muratajt dhe grupit të tij. Ka

dyshime se kishte lidhje intime me njërin nga anëtarët e bandës. TV Klan mëson se ajo ka marrë pjesë edhe në grabitjen e 9 Shkurtit 2017,

ku në rrugën e Rinasit u grabitën rreth 3,8 milionë euro. Edhe në këtë ngjarje, ajo ka qenë e ngarkuar me transportin e parave. Ndërsa, shkëputja e saj nga puna përkon me grabitjen e parë, që ka bërë grupi i Admir Muratajt, tek një bankë e nivelit të dytë pranë Stacionit të Trenit. Hetimet kanë zbuluar gjithashtu se grupi që kreu grabitjen, përbëhet nga 17 anëtarë, ku 9 prej tyre janë identifikuar, ndërsa të arrestuar janë 5.



Ish-policia 31-vjeçare, E. Bici

LËVIZJA E PARAVE

31-vjeçarja, sipas burimeve nga Prokuroria për Krimet e Rënda, ka pasur rol të rëndësishëm në grabitje. Ajo dyshohet se është personi që ka bërë lëvizjen e parave nga makina, më të cilën u larguan grabitësit për në një vend tjetër. Shuma e parave, sipas hetuesve, besohet se është ende në zonën e Niklës



DY KOSOVARËT NË KËRKIM

Nga dëshminë e Alkond Bengasit që ka tashmë statusin e bashkëpunëtorit të drejtësisë, policia zbuloi përfshirjen e dy personave nga Kosova në grabitjen e Rinasit. Nuk dihet ende se cili ka qenë roli i tyre në këtë ngjarje, por Alkond Bengasi ka pranuar se në drekën mes tij e Admir Muratajt, por edhe dy kushërinjëve të tij nga Elbasani, Klement Çala dhe Eldi Çala kanë qenë edhe dy kosovarë, njëri prej tyre i njohur me pseudonimin "Tani".

Grabitja e milionave eurove, Shoqata e Bankave: Të zgjidhet siguria në aeroport

TIRANË - Vjedhja e miliona eurove në aeroportin e Rinasit vazhdon të mbajë të bllokuar transportin jashtë të vlerave monetare të Bankave. Për këtë arsye bankat janë ende në kërkim të një zgjidhjeje. Për Silvio Petrazzin kryetarin e Shoqatës së Bankave, e rëndësishme është që zgjidhja të gjendet para sezonit të verës, kur remitancat nga emigrantët rriten bashkë me të ardhurat e vendit nga turizmi. "Kur kompania na njoftoi se nuk do të bënte më transferta na zuri në befasi. Për momentin transferimi i parave është i ndërprerë. Mundësia e vetme teknike është që të transportojmë me automjete drejt Kosovës ose Greqisë. E vetmja gjë që mund të bëhet është të merren masat e duhura që të garantojnë sigurinë në mënyrë që linjat të rikthejnë transportin e parave. Tashmë jemi në diskutime, shpresojmë të gjejmë një zgjidhje para verës." Në ditët e para pas grabitjes, një pjesë e bankave filloi të refuzojë blerjen e valutës së tepërt, gjë që solli një dobësim të konsiderueshëm të euros në treg. Drejtuesit e bankave thotë Petrazzi vendosën bashkërisht pak ditë më



vonë të vijonin të blinin valutë si normalisht për të shmangur çrregullimet në treg. "Një ditë pas grabitjes disa banka ndaluan së pranuari para por mesa di unë asnjë bankë nuk e ka ndaluar shërbimin. Kemi pasur dy takime ne si shoqatë bankash dhe mund të them në mënyrë të përgjeshme që do të vazhdojmë të ofrojmë shërbimet në mënyrë që të mos çrregullojmë tregun. Një ditë pas grabitjes kursi i këmbimit ndryshoi dhe euro ra në mënyrë drastike dhe më pas u rikuperua sepse bankat rinisën shërbimin. Ky ishte një veprim i përgjeshëm që duhej përkthyer në veprime". Një bankë, tha Petrazzi, mund të kryejë katër apo pesë transferta në muaj. Ndaj si kryetar i Shoqatës së Bankave kërkon rritjen e masave të sigurisë jo vetëm në Rinas,

por në të gjithë sistemin e transportit të vlerave monetare. "Ajo që është e rëndësishme është që të implementohet një set masash të cilat do ta bëjnë të sigurtë aeroportin, jo vetëm aeroportin, por edhe rrugën për në aeroport. Pra, bankat janë duke e bërë pjesën e tyre të punës, por kjo është një zinxhir; një zinxhir që fillon me bankat, përfshin kompanitë e sigurisë për transferat e parave, përfshin Policinë e Shtetit, sigurinë e aeroportit dhe kompaninë që dërgon paratë jashtë." Në 9 prill në aeroportin e Rinasit një grup i strukturuar kriminal hynë në pistën e aeroportit dhe grabitën nga barku i avionit 6.5 mln euro të cilat i përkisnin tre bankave të nivelit të dytë në vend dhe do të transferoheshin në Vjenë.

erja



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi 3-vjeçar i mirëmbajtjes dhe riparimit të motogjeneratorëve dhe stabilizatorëve të Bankës së Shqipërisë"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 8,660,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në Illogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:
Përfuttes: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshirmit: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi 3-vjeçar i mirëmbajtjes dhe riparimit të motogjeneratorëve dhe stabilizatorëve të Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 17 Maj 2019, ora 14:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



Grabitja në Rinas, gjykata lë në burg imamin radikal dhe dy bashkëpunëtorët

TIRANË - Gjykata e Krimeve të Rënda ka dhënë dje masën "arrest me burg" për tre nga të arrestuarit e megagrabitjes në Rinas. Konkretisht, trup gjykoes ka lënë në qeli shtetasit: Renaldo Sula, 25 vjeç nga Elbasani; Saimir Çela, 28 vjeç nga Elbasani dhe Oltion Veseli, 38 vjeç nga Kruja. Ata të tre, të ulur në kafazin e hekurit janë dëgjuar për më shumë se dy orë nga gjykata, e cila pavarësisht pretendimeve të avokatëve mbrojtës, se nuk kishin lidhje me ngjarjen, i ka besuar provave të mbledhura nga grupi hetimor. Një ditë më parë, gjykata la në burg edhe Alkond Bengasin, i riu që zbrëtheu të gjithë grupin. Ish-te pikërisht dëshmia e këtij të fundit që e çoi policinë në gjurmën e personave të përfshirë për ngjarjen. Deri më tani janë 5 të arrestuarit për grabitjen dhe Admir Murataj i vrrarë. Por, ndërsa hetimet vijojnë flitet edhe për të paktën katër persona, mes tyre edhe një femër të përfshirë në ngjarje.

Zbardhet dosja, telefonata mes kunatave që çoi policinë në gjurmët e Klement Çalës

Alkond Bengasi: Si u takova me Admir Muratajn dhe 2 kosovarët në një lokal te "Shkëmbi i Kavajës" Furgonin që modifikova ma dhanë vëllezërit Çala

TIRANË

Një gjurmë gishti në pjesën e brendshme të furgonit me mbishkrimin "Hetimi Tati-mor" ishte "thembra e Akilit" që ndihmoi policinë në zbulimin e grupit të grabitësve që vodhën miliona euro në aeroportin e Rinasit mesditën e 9 prillit. Me këtë provë shkencore në duar, policia shkoi tek emri i Alkond Bengasit, i skeduar më herët për trafik narkotikësh. Ai u vu në pranga mbremjen e 20 prillit në Elbasan dhe menjëherë sapo u përball me faktet pranoi të bashkëpunojë me uniformat blu. Bengasi ka deklaruar se ai ishte personi që kishte modifikuar furgonin që u përdoren në grabitjen spektakolare në Rinas. Ka treguar përballë hetuesve se personat e përfshirë në grabitjen e 9 prillit janë kushërinj të tij, Klement dhe Eldi Çala. Jo vetëm kaq, por Alkond Bengasi ka treguar edhe takimin me kreun e grupit Admir Murataj dhe kërkesën e tyre për të bërë modifikimin e furgonit, më të cilin grabitjen thasët me euro në Rinas. Ndërkaq, në dosjen e Prokurorisë, siguruar për "Neës 24" dhe "Gazeta Shqiptare" zbulohet edhe mënyra se si ka mbërritur policia në gjurmët e Klement Çalës, i konsideruar ndryshe si "mjeshtër i grabitjeve". Mësohet se ka qenë një telefonatë mes kunatave të Klementit, të përgjuara fill pas grabitjes. Ndërkohë, ditën e djeshme, Gjykata për Krime të Rënda la në arrest në burg 3 nga të arrestuarit për grabitjen e 9 prillit. Seanca u zhvillua me dyer të mbyllura. Renaldo Sula, 25 vjeç Saimir Çela, 28 vjeç, dhe 38-vjeçari Oltion Veseli kanë mbetur në qeli, ndërsa mësohet se ata i kanë mohuar akuzat në lidhje me grabitjen e mijëra eurove në Rinas.

DËSHMIA E ALKOND BENGASIT

"Pesë muaj më parë u punësova në servis të Eldi Çala kishte marrë me qira. Klement Çala dhe vëllai Eldi më kërkuan t'i shoqëroja në Kavajë, për të marrë një furgon. Kemi shkuar të tre dhe jemi ulur në një lokal te Shkëmbi i Kavajës. Aty na prisin tre persona. Njëri u prezantua si Admir Murataj ose Adi Trojopani, të cilin e thërrisnin me pseudonimin "daja". Ndërsa, dy të tjerë ishin nga Kosova, njërin prej të cilëve e thërrisnin "Tani". Pasi hëngrëm drekë morëm



I përnduar i drejtësisë, Alkond Bengasi



Klement Çala

TIRANË - Me sa duket policia ka nisur të shturë rrjetën e krijuar prej grupit të grabitësve të miliona eurove në aeroportin e Rinasit dhe të nxjerrë një nga një të dyshuarit. Imazhi i një tjetër të kërkuarit është zbuluar pasditën e djeshme nga gazetarja Klodiana Lala. Bëhet fjalë për shtetasin Eldi Çala, vëllai i Klement Çalës, të ashtuquajturit "Mjeshtër i grabitjeve", person me rekord të theksuara kriminale në fushën e grabitjes në Shqipëri e Greqi. Emri i Eldi Çalës doli gjatë hetimeve për grabitjen e 9 prillit, ndërsa u zbulua se roli i tij ka qenë përgatitja e bazës materiale, të paktën deri tani. Kjo pasi, Eldi Çala ishte personi që mori me qira servis ku dhe filloi realizimin i planit të grabitjes, pasi aty u krijua furgoni i grabitjes spektakolare. Policia ka arrestuar kushëririn e vëllezërve Çala, Alkond Bengasi, i cili është kthyer në bashkëpunëtor të policisë. Vëllezërit Çala janë të dy në kërkim nga policia. Të dyshuarit e tjerë të grabitjes që janë arrestuar

Si po zbrëthehet grabitja, "zbulohet" imazhi i Eldi Çalës, personi që mori me qira servis



Eldi Çala

PERSONAT E ARRESTUAR NË LIDHJE ME GRABITJEN NË RINAS

- | | |
|-------------------|----------------------|
| 1. Alkond Bengasi | 34 vjeç nga Elbasani |
| 2. Renaldo Sula | 25 vjeç nga Elbasani |
| 3. Oltion Veseli | 38 vjeç nga Kruja |
| 4. Saimir Çela | 28 vjeç nga Elbasani |
| 5. Elton Piki | 32 vjeç nga Kruja |

furgonat, të cilët më pas i modifikova. Më vonë mësova se mjetet do të përdroshin për grabitje". Mes të tjerash, para grupit hetimor Bengasi tha se me furgonin e modifikuar kushërinj të tij kanë bërë rreth 2 muaj prova për të testuar nëse mund të rezistonte në tërheqjen e betoneve dhe shkallmimin e dyerve. "Furgoni ka qenë tip tjetër dhe e bëmë Volkswagen. Më kërkuan bateri shtesë në pjesën e parë. Aty ka ardhur edhe Olti (Veseli) dhe personi me emrin Tani", ka thënë Bengasi. Mbi bazën e kësaj dësh-

mie, policia shqiptare po bashkëpunon me atë kosovare për identifikimin dhe arrestimin e dy personave, të përmendur nga Bengasi si "Daja" dhe "Tani", të cilët dyshohen të përfshirë në grabitjen e 9 prillit, edhe pse mbetet i paqartë roli i tyre. Burimet pranë grupit hetimor thanë se Bengasi, kushëri me Klement Çalën, u dha emrat e 9 personave të përfshirë në krim, por asnjë detaj lidhur me shumën e parave. Në dosjen e Prokurorisë thuhet ndër të tjera që Alkon Bengasi i ka identifikuar grab-

bitësit e tjerë nëpërmjet fotove. Hetuesit i kanë nxjerrë atij foto të të dyshuarve dhe ai ka identifikuar ata që njihje apo kishte takuar. Mësohet po ashtu se për ngjarjen janë edhe tre persona të tjerë në kërkim, por edhe një femër. **TELEFONATA** Përgjimet kanë çuar hetuesit e çështjes në gjurmët e Klement Çalës, njëri prej organizatorëve të megagrabitjes në Rinas. Ka qenë një telefonatë mes kunatave të Klementit, të përgjuara fill pas grabitjes. Gratë kanë

deri tani janë Renaldo Sula, Saimir Çela, Alkond Bengasi dhe Oltion Veseli dhe 32-vjeçari nga Kruja Elton Piki. Ky i fundit u prangos dy ditë më parë në Qafë-Thanë teksa po tentonte të ikte për në Bullgari. Sipas burimeve policore Piki, i cili nuk rezultoi të jetë person i skeduar u kap në Qafë-Thanë teksa po tentonte të largohej drejt Bullgarisë. Materialet procedurale një ngarkim të tij i kaluan Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për veprat penale: "Vjedhje me armë të kryer në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar Kriminal", "Mbajtje pa leje e armëve dhe municioneve luftarake"; "Vrasje e punonjësit të Policisë e kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë".

shprehur shqetësimin se personi që mund të ishte vrasë gjatë shkëmbimit të zjarrit me policinë mund të kishte qenë pikërisht Klementi. Po ashtu, në dosje thuhet se në përgjim kanë qenë edhe familja e Admir Murataj. Pastel telefonatë mes kunatave, janë mbledhur informacione në rrugë operative dhe kanë gjetur servis si edhe mbetje të furgonit. Pikërisht në atë kohë Bengasi ka pranuar të bashkëpunojë. Deri më tani ai nuk ka dhënë asnjë detaj në lidhje me vendndodhjen e parave të grabitura në Rinas.

"Këta janë kriminelë, duhet të paguajnë për atë që ndodhi"

Vdekja e nënës së re, gjykata liron 2 mjekët, familjarët protestë me foshnjën e 25-vjeçares në krahë

ELBASAN - Është shoqëruar me protesta dhe tensione, seanca gjyqësore për vendosjen e masës së sigurisë ndaj dy mjekëve në Elbasan, të cilët u arrestuan si përgjegjës për vdekjen e 25-vjeçares Rexhina Debroya, një orë pas lindjes. Në fund të seancës, togat e zeza të këtij qyteti vendosën masën e sigurisë "detyrim paraqitje" ndaj kardiologut Mehmet Ibaq dhe reanimatorit Nikollaq Thana. Dy mjekët u prangosën për mjekim të pakujdesshëm. Megjithatë gjatë marrjes në pyetje, ata i mohuan akuzat. Ata thanë se Debroya ndërroi jetë si pasojë e një patologjie që hyn në rastet e

BASHKËSHORTI I VIKTIMËS

Familjarët të indinjuar nga humbja e së resë kërkuan drejtësi. "A do ia festojmë dot ditëlindjen Aleas ne? Nuk do t'ia festojmë dot, sepse do të na kujtohet ngjarja tjetër". Kështu u shpreh dje bashkëshorti i Rexhina Debroyës, nënës së re e cila humbi jetën në spitalin e Elbasanit.

rralla të komplikacioneve (koagolimi i gjakut).

Gjatë kohës që në gjykatë zhvillohej seanca për masën e sigurisë, jashtë saj ishin mbledhur familjarët e vik-

timës, të cilët kërkuan që mjekët të lëshoheshin në burg. Në krahë, ata mbanin edhe foshnjën e porsalindur të 25-vjeçares. Ndërkohë, policia ka rrethuar Gjykatën e El-

basanit. Mjekët në fjalë u akuzuan nga familjarët e 25-vjeçares për neglizhencë dhe mungesë profesionalizmi. Rexhina Debroya humbi jetën pas lindjes në spitalin e Elbasanit më 22 prill. Familjarët të indinjuar nga humbja e së resë kërkuan drejtësi. "A do ia festojmë dot ditëlindjen Aleas ne? Nuk do t'ia festojmë dot, sepse do të na kujtohet ngjarja tjetër". Kështu u shpreh dje bashkëshorti i Rexhina Debroyës, nënës së re e cila humbi jetën në spi-



25-vjeçarja Rexhina Debroya dhe familjarët në protestë

talit e Elbasanit. Familjarët e së ndërjes, me foshnjën e porsalindur në duar dolën u mblodhën dje para Gjykatës së Elbasanit për të protestuar kundër lirim-it të mjekëve Mehmet Ibaq

dhe Niko Thana. "Këta janë kriminelë", "duhet të paguajnë", ishin disa prej akuzave që ata lëshuan në drejtim të mjekëve, të cilët i bëjnë fajtorë për vdekjen e 25-vjeçares.

"Islami fundamentalist e ka prekur atë përmes propagandës në internet"

ITALI

Bledar Ibrahim i ishte një djalë i ri vetëm njëzet vjeç që erdhi nga Shqipëria dhe përfundoi pothuajse rastësisht në Pozzo d'Adda, një qytet me gjashtë mijë banorë në kufi me krahinën e Bergamas.

Kështu e nis shkrimin e saj prestigjiozja italiane "Corriere Della Sera" e cila ka publikuar detaje mbi jetën e 28-vjeçarit Bledar Ibrahim, i arrestuar një ditë më parë në Elbasan dhe i dëbuar nga Italia në 3 mars të 2016 me akuzën e përkrahjes së propagandës terroriste të Shtetit Islamik ISIS. Në artikull tregohet se si arriti Bledar Ibrahim të vendoste kontakte me luftëtarët e ISIS në territorin italian, në rajonin e Lombardisë.

"Islami fundamentalist e ka prekur atë përmes propagandës në internet. Kjo e bëri të mohonte origjinën dhe tokën e tij dhe të betohej në emër të Allahut dhe ushtrisë së Kalifatit. Bledari ndryshoi emrin dhe profilin e 'Facebook' (Yahya Ibrahim). Në postimet e tij ai shkruan se 'Siria dhe Iraku' janë 'për të gjithë myslimanët' dhe thërriste të 'mbrojnë Allahun' për Kalifin e Bagdadit", thuhet ndër të tjera në shkrim.

"Profesori kishte nisur karrierën e studimeve fetare të certifikuar në Egjipt për t'u bërë një imam radikal. Ishte transferuar në Kajro për të studiuar në një Universitet arab e për të mësuar bazat e fesë myslimane në një shkollë Kurani. Në të njëjtën periudhë në Egjipt ka jetuar dhe motra e tij, Rexhina 20 vjeç e bashkëshorti i saj italian nga Lombardia i konvertuar në mysliman me emrin Icaro Bilal Masseroli. Motra dhe burri i motrës së Bledar Ibrahimit janë dëbuar nga Egjipti të akuzuar për fundamentalizëm. Në fund të muajit shkurt të 2016 Bledar Ibrahim rikthehet nga Egjipti në Itali duke kaluar përmes Frankfurtit ku qëndron dy ditë e më pas udhëton për 8 orë me autobus drejt Milanos. I sapo kthyer në vendin e rezidencës së tij në komunën Pozzo D'Adda, Bledar

Bledar Ibrahim, "profesori" i ISIS nga Elbasani që ngriti në këmbë Italinë

"Corriere Della Sera": Ja si u lidh 28-vjeçari me terroristët në territorin e Lombardisë



Bledar Ibrahim

EKSTRADIMI
Por pse u kërkua ekstradimi i tij nga Shqipëria drejt Italisë? 'Corriere Della Sera' shkruan se autoritetet italiane kanë rindërtuar çdo pjesë të "ushtrisë së xhihadistëve në Lombardi", janë zbardhur të gjitha kontaktet telematike e telefonike mes personave të arrestuar, të dëbuar e luftëtar të ISIS dhe pikërisht nga gjithë këto prova bie në sy roli "superior" i Bledar Ibrahimit.

LIDHJA ME ISIS
Sipas mediave italiane, Bledar Ibrahim kishte lidhur miqësi me një pjesë të mirë të mbështetësve të ISIS në Lombardi si me Giulia Maria Sergio (lady xhihad italiane e martuar me shqiptarin Aldo Kubozi), me pakistanezin e sapodëbuar nga Italia për terrorizëm, Aftab Farooq, me shqiptarin Idriz Elvis Elezi, me torinezin Halili El Mahdi, autori i dokumentit të parë të ISIS në gjuhën italiane. Ai po ashtu kishte krijuar lidhje me të afërmit e luftëtarit të ISIS nga provinca e Vareses, Oussama Khachia".

Ibrahim ka kërkuar një kartë të re identiteti dhe pse ajo që zotëronte nuk i kishte skaduar ende. Në kartën e vjetër të identitetit Bledar Ibrahim shfaqet me mjekër të gjatë ndërsa në momentin që ka kërkuar një kartë të re identitetit është prezantuar pa

mjekër", thuhet ndër të tjera në shkrim.
Shkrimi vijon më tej: "Ibrahim kishte lidhur miqësi me një pjesë të mirë të mbështetësve të ISIS në Lombardi si me Giulia Maria Sergio (lady xhihad italiane e martuar me shqiptarin Aldo

Kubozi), me pakistanezin e sapo dëbuar nga Italia për terrorizëm, Aftab Farooq, me shqiptarin Idriz Elvis Elezi, me torinezin Halili El Mahdi, autori i dokumentit të parë të ISIS në gjuhën italiane. Ai po ashtu kishte krijuar lidhje me të afërmit e luftëtarit të

"PROFESORI"
Bledar Ibrahim ka karrierën e studimeve fetare të certifikuar në Egjipt për t'u bërë një imam radikal. Ishte transferuar në Kajro për të studiuar në një universitet arab e për të mësuar bazat e fesë myslimane në një shkollë Kurani. Në të njëjtën periudhë në Egjipt ka jetuar dhe motra e tij, Rexhina 20 vjeç e bashkëshorti i saj italian nga Lombardia i konvertuar në mysliman me emrin Icaro Bilal Masseroli. Motra dhe burri i motrës së Bledar Ibrahimit janë dëbuar nga Egjipti të akuzuar për fundamentalizëm.

ISIS nga provinca e Vareses, Oussama Khachia". Pasi është dëbuar nga Italia Bledari jetonte në Elbasan me gjyshërit e tij, pasi i është ndaluar të hyjë në territorin e Bashkimit Europian për 10 vite.

Por pse u kërkua ekstradimi i tij nga Shqipëria drejt Italisë? Corriere Della Sera shkruan se autoritetet italiane kanë rindërtuar çdo pjesë të "ushtrisë së xhihadistëve në Lombardi", janë zbardhur të gjitha kontaktet telematike e telefonike mes personave të arrestuar, të dëbuar e luftëtar të ISIS dhe pikërisht nga gjithë këto prova bie në sy roli "superior" i Bledar Ibrahimit.

Italia kërkon ekstradimin e Ilir Bajrit, shtyhet seanca në Shkodër

SHKODËR - Gjykata e Shkallës së Parë në Shkodër është blindur në orët e paradites së djeshme nga forca të shumta policie. Për shtetasin Ilir Bajri Rustemi, i arrestuar si pjesë e grupit Bajri është zhvilluar një seancë për masë sigurimi ndaj tij. Italia ka sjellë një vendim për ekstradimin e Ilir Bajrit Rustemi në shtetin italian. Në vitin 2008-2009 gjykata e Bolonjas në Itali e ka gjykuar dhe dënuar për akuzën "trafik narkotikësh dhe shfrytëzim prostitucioni" dhe është dënuar përfundimisht me 5 vite e gjysmë burg. Në gjykatën e shkallës së parë në Shkodër u zhvillua një seancë për masë sigurie për ekstradimin e tij drejt Italisë për këtë dënim në shtetin italian. Ilir Bajri Rustemi ishte i pranishëm në seancë, por masa e sigurisë ndaj tij u shty për një datë tjetër për shkak se nuk kishte avokatim mbrojtës.

Ilir Bajri Rustemi u arrestua në shtator të vitit të kaluar si pjesë e grupit "Bajri" të dyshuar si pjesë e një grupi të strukturuar kriminal bashkë me disa persona të tjerë ndërsa çështja ndaj tyre vijon ende tek krimet e rënda. Tashmë pritet për t'u parë nëse dënimin që ka në Itali, Ilir Bajri Rustemi pas vendimit për ekstradim dhe njohjes së këtij vendimi në Shqipëri do ta vuajë në shtetin italian apo këtu në Shqipëri. Gjatë gjithë kohës kur u zhvillua kjo seancë e masës së sigurisë në Shkodër, gjykata e shkallës së parë ishte e rrethuar nga forca të shumta policie. Pas seancës që zgjati jo më shumë se 10 minuta, Ilir Bajri Rustemi u shoqërua nën masa të rrepta sigurie drejt paraburgimit në pritje të seancave të tjera tek krimet e rënda dhe gjykata e Shkodrës për qëllim ekstradimi.

Robert Gajda vlerëson bashkëpunimin. Ruka: Raportet të prezantohen para të rinjve

"Luarasi" nënshkruan marrëveshjen me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Studentët, mundësi praktike mësimore pranë KMD-së

Diskriminimi i ushtruar në forma nga më të ndryshmet, është ende një problem i mprehtë në shoqërinë tonë. Një nga mënyrat më efektive për mbrojtjen nga ky fenomen është arsimimi dhe edukimi cilësor i brezave të rinj. Lidhur me këtë kauzë të rëndësishme, universiteti "Luarasi" ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

MARRËVESHJA

Thelbi i marrëveshjes synon prekjën nga afër të realitetit, evidentimin e faktorëve diskriminues si dhe realizimin e praktikave pranë KMD-së nga studentët e Luarasit. Rektori i universitetit, prof. dr. Ethem Ruka tha se raportet e paraqitura në parlament mbi këtë kauzë duhet të prezantohen edhe para studentëve. "Ka një sërë problemesh, duke nisur nga barazia gjinore, besimet fetare, problemet e punësimit, dallimet midis komuniteteve të ndryshme. Ky është një problem i kulturës dhe edukimit të brezave të rinj, të cilët duhet të edukohen me një frymë tjetër kundër diskriminimit. Një raport që do të paraqisni në parlament, do të ishte shumë interesant për ta transmetuar edhe te rinia. Në kuadrin e bashkëpunimit, studentët e Drejtësisë të mund të vijnë dhe të shikojnë problemet pranë institucionit tuaj, zbatimin e ligjit", tha prof. dr. Ethem Ruka gjatë takimit.

OBJEKTIVI

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda e vlerësoi si një bashkëpunim efektiv nënshkrimin e marrëveshjes. Ai tha se universiteti mund të kthehet në një qendër de-



ROBERT GAJDA "BASHKËPUNIM PRODUKTIV"

"Në çfarëdolloj aspekti që ta shikojmë bashkëpunimin mes institucionit tonë dhe universitetit "Luarasi", është në të gjitha aspektet pozitiv dhe produktiv. Patjetër që praktika e studentëve në institucion është diçka shumë e mirë. Edhe konferencat shkencore janë në fokusin tonë gjithashtu", - u shpreh Gajda.



ETHEM RUKA PROBLEMATIKAT

"Ka një sërë problemesh, duke nisur nga barazia gjinore, besimet fetare, problemet e punësimit, dallimet midis komuniteteve të ndryshme. Ky është një problem i kulturës dhe edukimit të brezave të rinj, të cilët duhet të edukohen me një frymë tjetër kundër diskriminimit", - tha prof. dr. Ethem Ruka gjatë takimit.



bati e konferencash shkencore për diskutimin e çështjeve kundër diskriminimit. "Në çfarëdolloj aspekti që ta shikojmë bashkëpunimin mes institucionit tonë dhe

universitetit "Luarasi", është në të gjitha aspektet pozitiv dhe produktiv. Patjetër që praktika e studentëve në institucion është diçka shumë e mirë, po dilet nga ai kon-

cepti abstrakt i barazisë dhe diskriminimit dhe po vihen në jetë termat konkretë. Në universitet mund të prezantohen raportet që mund të kapen nga këndvështrime të

ndryshme. Edhe konferencat shkencore janë në fokusin tonë, gjithashtu", - u shpreh Gajda.

PROPOZIMET

Gjatë takimit, stafi akademik i "Luarasit" solli edhe disa sugjerime për realizimin konkret të marrëveshjes. "Do ishte shumë mirë që studentët tanë të kishin akses në dokumentet që ju keni dhe të gjitha ato që prodhoni si raporte vjetore. Do ishte mirë të bëheshin edhe shkëmbime të librave ose të materialeve të tjera që mund t'i shtohen bibliotekës sonë", tha në fjalën e saj dekanja e Fakultetit të Drejtësisë, Rezana Konomi. Ndërkohë përgjegjësjë e Departamentit të Menaxhim-Biznesit në "Luarasi", dr. Shkencave Aelita Mani i bëri ftesë KMD-së për leksione të hapura në këtë universitet. "Mund ta ktheni "Luarasi-n" në tri-

bunën tuaj për të prezantuar nisma, ide, raporte, risitë më të fundit dhe praktikat kundër diskriminimit", -tha Mani.

PËRGJEGJËSITË E KMD-së

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është autoriteti përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi. Institucioni e mbështet veprimtarinë e tij në zbatimin e të gjithë mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë. Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër. Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shansave dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Manastirliu: Investim edhe në 100 qendra shëndetësore

Ministrja, apel prindërve: Kujdes, mos refuzoni vaksinimin e fëmijëve!

Në Javën Europiane të Vaksinimit, ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu i ka bërë thirrje prindërve që të vaksinonin fëmijët e të respektojnë me rigorozitet kalendarin e vaksinimit. "Jemi këtu për të promovuar dobinë e vaksinimit për parandalimin e sëmundjeve të rrezikshme, ndaj ju them të gjithë prindërve, të mos bazohen në argumente të paarsyeshme, por të ndjekin me rigorozitet kalendarin e vaksinimit", tha

Manastirliu. Apelit të ministres i është bashkuar edhe ekspertja e Institutit të Shëndetit Publik, Silva Bino, e cila garantoj sigurinë dhe efikasitetin e vaksinave. "Dua të bëj një apel për prindërit, të mos hezitohen për kryerjen e vaksinave, sepse përfitimet që vijnë nga vaksinimi janë të paarritshme dhe prandaj nuk duhet të kemi frikë nga vaksinat sepse vaksinat janë të sigurta", -tha Bino.

INVESTIMI

"Investimi i parë i rëndësishëm që nis këtë vit për ruajtjen e zinxhirit ftohës të vaksinave, do të rrisë sigurinë e vaksinimit", tha ministrja Manastirliu, gjatë vizitës në qendrën shëndetësore Kashar 1, në periferi të Tiranës. Kjo qendër është rehabilituar plotësisht në kuadër të programit kombëtar të 300 qendrave shëndetësore. Gjatë vizitës në qendrën shëndetësore të

rehabilituar të Kasharit, Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale shprehë edhe nga deputetja e zonës Blerina Gjylameti, e cila vlerësoi investimin e qeverisë në këtë zonë të ekstremitet të Bashkisë Tiranë, duke theksuar se ndryshimi është i dukshëm jo vetëm në qendrat në zonat urbane, por në çdo komunitet.

Gjatë vitit 2018, vetëm në bashkinë e Tiranës u rehabilituan 15 qendra shëndetësore dhe 100 qendra



tësore, nga 80 që u rikonstruktuan në të gjithë vendin. Në këtë vit do të investohet për rehabilitimin dhe pajisjen e 100 qendrave

shëndetësore dhe ambulanca në të gjithë Shqipërinë, investime nga të cilat do të përfitojnë rreth 450 mijë qytetarë.

EDUKIMI EKONOMIK INTERVISTA

Eksperti i "Luarasit": Zgjidhjet afatgjata dhe afatshkurtra për përmirësimin e situatës

Prof. asoc. dr. Qirici: Shumica e mësuesve të Ekonomisë në gjimnaze, të patrajnuar

"Konsumatorët e informuar mund të shmangin abuzimet"

Voltiza Duro

Edukimi ekonomik është një vlerë e shtuar për shoqërinë e ndihmon në zhvillimin e mirëqenies së saj. Ditën e sotme, "Gazeta Shqiptare" publikon pjesën e dytë të intervistës me prof. asoc. dr. Stefan Qirici, ekspert ekonomie e njëkohësisht pedagog në universitetin "Luarasi". Profesori pohon se kur qytetarët e vendit janë të aftë për të krijuar, ndërtuar pasuri dhe mirëqenie personale, ato janë, gjithashtu, të aftë për të ndërtuar dhe zhvilluar ekonomi të qëndrueshme me rritje reale ekonomike. Qirici shton se shqiptarët jo vetëm që duhet të kenë qasje në informacion, por, gjithashtu, duhet të jenë në gjendje që edhe ta kuptojnë, interpretojnë dhe ta përdorin atë dhe të mbajnë qëndrimin e duhur dhe të marrin vendimet e duhura. Ai thekson se një tjetër mangësi vihet re edhe në shkollat e mesme ku shumica e mësuesve janë të pa trajnuar për t'u mësuar ekonominë dhe financat personale nxënëseve.

Pse përvetësimi i njohurive ekonomike është i domosdoshëm për qytetarët e një shoqërie demokratike?

Ekonomistët pranojnë se promovimi, zhvillimi dhe përvetësimi i njohurive themelore ekonomike dhe financiare është një qëllim i rëndësishëm në veçanti për një shoqëri demokratike që mbështetet shumë në qytetarët e



Prof. asoc. dr. Qirici

saj që janë të informuar dhe në vendimmarrjen ekonomike individuale të tyre. Një miku im më ka treguar se në një fushatë elektorale kandidati për deputet i zonës po u fliste zgjedhësve të vet midis të tjerave edhe për treguesin e GDP-së të cilin partia e tij e kishte rritur nga viti në vit. Një zgjedhës andej nga fundi i sallës bërtiti: "Rroftë GDP-ja!" dhe salla duartrokoi me ovacione! Kjo situatë është sa komike aq edhe tragjike dhe flet shumë për mangësinë e njohurive bazike të qytetarëve për treguesit kryesorë të ekonomisë dhe funksionimit të vetë ekonomisë. Kur qytetarët e vendit janë të aftë për të krijuar, ndërtuar pasuri dhe mirëqenie personale, ato janë, gjithashtu, të aftë për të ndërtuar dhe zhvilluar ekonomi të qëndrueshme me rritje reale ekonomike.

Pse thuhet dhe duhet të pranojmë se njohuria është

të edhe fuqi?

Në një mjedis ekonomik dhe tregje me zhvillime dinamike gjithnjë në ndryshim, dhe gjithnjë e më konkurrues, njohuria është dhe konsiderohet fuqi. Ne sot jetojmë në një epokë në të cilën mjetet e shumta të komunikimit masiv i kanë "mbytur" konsumatorët me më shumë informacione se sa kurrë më parë, dhe aktualisht tregjet ekonomike dhe financiar janë bërë akoma më shumë kompleks dhe më konkurrues se më parë.

A mund të theksojmë se sa më shumë informacion kemi aq më shumë njohuri kanë qytetarët?

Kjo është një pyetje shumë e mirë. Mendoj se, të kesh më shumë informacion, i cili mund të vijë nga shumë drejtime të ndryshme, nuk do të thotë se edhe njerëzit kanë më shumë njohuri. Përballë këtij informacioni masiv "që derdhet si lumë" ndaj

qytetarit, ai duhet të orientohet, sipas rastit duhet të mbajë qëndrim, duhet të diskutojë dhe debatojë, duhet të reflektojë, dhe të sugjerojë edhe për zgjidhje të mundshme. Pra, duhet të theksojmë se një qytetar aktiv duhet të mbajë qëndrim aktiv ndaj informacionit që merr. Por, asnjëherë nga sa theksuam më lart nuk mund ta realizosh si duhet në qoftë se nuk ke dhe nuk zotëron njohuritë e duhura qofshin këto njohuri bazë apo të specializuar të fushës së ekonomisë.

Cila është sfida e shqiptarëve në edukimin ekonomik sipas jush?

Qytetarët shqiptarë jo vetëm që duhet të kenë qasje në informacion, por, gjithashtu, duhet të jenë në gjendje që edhe ta kuptojnë, interpretojnë dhe ta përdorin atë dhe të mbajnë qëndrimin e duhur dhe të marrin vendimet e duhura. Kjo mendoj se është

NJOHURITE EKONOMIKE

Ekonomistët pranojnë se promovimi, zhvillimi dhe përvetësimi i njohurive themelore ekonomike dhe financiare është një qëllim i rëndësishëm në veçanti për një shoqëri demokratike, që mbështetet shumë te qytetarët e saj që janë të informuar dhe në vendimmarrjen ekonomike individuale të tyre.



SHIFIDA NE EDUKIMIN EKONOMIK

Qytetarët shqiptarë jo vetëm që duhet të kenë qasje në informacion, por gjithashtu, duhet të jenë në gjendje që edhe ta kuptojnë, interpretojnë dhe ta përdorin atë dhe të mbajnë qëndrimin e duhur dhe të marrin vendimet e duhura. Kjo mendoj se është edhe sfida jonë.

Mund të theksojmë se aktualisht është mjaft e vështirë edhe për një qytetar shqiptar mesatar (në kuptimin e njohurive ekonomike që zotëron) që të kuptojë dhe të zgjedhë me mençuri në mesin e shumë produkteve dhe shërbimeve financiare komplekse që janë në dispozicion sot në tregjet bankare apo financiare. Përfytyroni, për shembull, se sa i suksesshëm do të jetë një qytetar apo një fermer që vjen nga në një zonë rurale, larg qytetit, i cili nuk ka njohuri qoftë edhe bazike se si funksionon banka, çfarë dokumentesh duhet të të dorëzohë dhe si t'i përgatisë ato kur do t'i drejtohet bankës për të negociuar për një marrëveshje për të marrë kredi bankare.

Në një rast të tillë negociimi do të jetë i pasuksesshëm ose banka do të jetë superiore në marrëveshje ndaj një klienti të tillë që nuk ka formimin e duhur ekonomik dhe financiar. Por, a mund të mendohet sot një ekonomi tregu dinamike në zhvillim e saj pa funksionim normal të sistemit bankar?

A do të sillte kjo një mirëqenie më të lartë të vendit?

E theksojmë se, edukimi i qytetarëve me njohuritë bazë të ekonomisë së tregut, pse jo edhe me njohuri specifike, është një çështje me rëndësi kritike sa individuale por edhe shoqërore. Parë në një këndvështrim më të gjerë, jo vetëm në edukimin ekonomik, mund të thek-

NJOFTIM PËR SHITJE ME ANKAND

Permbarusit gjyqësore Geni Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurinë me të dhenat : "me të dhenat : "Fruall+Nderëse" me sip. totale 202.5 m2 dhe nga kjo ndërtesë me sip.65 m2, me Nr pasurie 7934, vol 38, fq 125, ZK 8592 e ndodhur ne Lagjen Partizani , Shkodër...e ofisuar ne favor te debitorit Izmir Hebovija .
2. Cmiri me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e sipërpershkruar , është në vlerën : 9,120,000 (nentemilione e njëqind e njëzet mijë) leke .
3. Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me date 05.05.2019 ora 16.16 ne Zyrën e permbarusit gjyqësore Geni Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Partisalle Gjyqësore se rrethit Gjyqësore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhen perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Tirana Bank dega Shkoder ne nr llogarie 0600-313839-100 CB

NJOFTIM PËR SHITJE ME ANKAND

1.Permbarusit gjyqësore Geni Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurinë me të dhenat : "Ndertesë njëkateshe industriale" me nr pasurie 1077ND , Volumi 24 , Faxe 143, me sipërfaqe ndërtime 1 235 m2 , Zona kadastrale 8592, e ndodhur tek zona industriale e qytetit , pjese e ish parkut te mallrave , Shkodere regjistruar ne favor te Altin Salhiu etj .
2. Cmiri me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e sipërpershkruar , është në vlerën : 24,240,000 (njëzetë kater milione e dyqind e katerdhjetë mijë) leke .
3. Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me date 03.05.2019 ora 16.16 ne Zyrën e permbarusit gjyqësore Geni Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Partisalle Gjyqësore se rrethit Gjyqësore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhen perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Tirana Bank dega Shkoder ne nr llogarie 0600-313839-100 CB .

SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k
Rr. "Fishe Daz", Kompleksi Kika 2, Kulla 5, Kt. 1, Tirane
Web: www.3h.al; Email: shq.3h@gjyqesore.com; tel: 0600305711

Njofton shpalljen e ankandit nga dt.23.04.2019 deri ne dt. 02.05.2019 persendin e luajtshe- gjysem rimore, marka Shmitz, Spr me Targa AER 936, me cmim fillestar 199,824.00 Leke automjetin gjysem rimore marka general trailers, F34 me Targa AER 360 me cmim fillestar 169,850.00 Leke ne pronesi te Subjektit Klodian Xhani PF me NIPT L02025004L
Ankandi zhvillohet ne zyrën permbarimore ne daten 02.05.2019 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00



EDUKIMI SI MIREQENIE

E theksojmë se edukimi i qytetarëve me njohuritë bazë të ekonomisë së tregut, pse jo edhe me njohuri specifike është një çështje me rëndësi kritike sa individuale, por edhe shoqërore.

sojmë se qytetarët e arsimuar të vendit janë çelësi i suksesit për mirëfunksionimin e ekonomisë së tregut, e cila i shërben së miri rritjes së mirëqenies të të gjithë anëtarëve të shoqërisë.

Pse duhet të kemi një qytetar që zotëron njohuri ekonomike?

Së pari, edukimi i qytetarëve për çështjet ekonomike është një pjesë integrale e edukimit të përgjithshëm të popullsisë. Një qytetar i edukuar nga pikëpamja ekonomike i ka të qarta dhe di të vlerësojë politikën ekonomike të propozuara të qeverisë që kanë ndikim në ekonomi në tërësi dhe në jetën e vetë qytetarit në veçanti. Njohuritë bazë të mënyrës së funksionimit të ekonomisë i ndihmojnë qytetarët të kuptojnë më mirë vendimet e politikëbërësve dhe se si ndryshimet në politikën ekonomike në fund të fundit ndikojnë në jetën e tyre. Edukimin e qytetarëve si konsumatorë duhet ta konsiderojmë si një as-

pekt jetik, një pjesë jetike për bizneset dhe ekonominë tonë. Edukimi ekonomik efektiv i ndihmon njerëzit të zhvillojnë aftësitë për të përmbushur objektivat e tyre personale ekonomike dhe financiare duke përfshirë këtu kursimet, stabilitetin financiar të të ardhurave personale familjare, pronësinë në shtëpi, arsimin e lartë ose daljen në pension.

A mund të shmangët abuzimi nga një konsumator i mirinformuar?

Është më mirë të jemi proaktiv në zhvillimin e një konsumatori të arsimuar, me njohuri të mjaftueshme për të shmangur abuzimin. Rëndësia e edukimit ekonomik të qytetarit është e qartë, por mbetet problem si ta realizojmë atë sa më mirë dhe që të jetë gjithëpërfshirës. Kjo mendoj se është sfida jonë. Gjithashtu, besoj se natyra e gjerë e problemit kërkon një ndërveprim aktiv, apo sulm mbi dy frontet: njëri front, si një zgjidhje afatgjatë dhe tjetri si përgjigje afatshkurtër

ndaj këtij problemi.

Cila do të ishte zgjidhja afatgjatë dhe ajo afatshkurtër?

Më lejoni të shpjegoj secilën pjesë të të kësaj qasjeje. Për një zgjidhje afatgjatë, për të eliminuar hendekun ekzistues në njohuritë ekonomike dhe financiare të qytetarëve, rol të veçantë kanë programet e edukimit ekonomik të fëmijëve që në bankat e shkollave. Pa dyshim, nisimat e gjera të edukimit ekonomik të mirë studiara dhe të aplikuar për fëmijët në moshë shkollare në të ardhmen do të përkthehen në një shoqëri me të rritur me qytetarë më të arsimuar në fushën e ekonomisë.

Aktualisht, në shkollat tona të mesme ka një lëndë "Ekonomia 12" që ofron njohuri mbi funksionimin e ekonomisë së tregut ku nxënësit marrin njohuri bazike teorike dhe praktike në fushën e mikroekonomisë dhe makroekonomisë.

A trajtohet siç duhet lënda e ekonomisë në shkollat e arsimit parauniversitar?

Mendoj se vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet cilësisë të mësimdhënies të kësaj lënde. Kur lënda jepet mësim nga mësues jo të specializuar krijon probleme, si rezultat njohuritë nuk përveçohen aq mirë sa duhet nga nxënësit. Si pasojë nxënësit që përfundojnë shkollën e mesme hyjnë në tregun e punës si pjesëmarrës në forcën punëtore pa e kuptuar se si funksionon ekonomia jonë e tregut - sistemi ekonomik dhe financiar i saj. Gjithashtu, njohuritë ekonomike, ku më shumë e ku më pak, trajtohen edhe në lëndë të tjera të shkollës por, është e rëndësishme që ato të jenë të trajtuara mirë, të harmonizuara në mënyrë të tillë që në tërësinë e tyre të na japin njohuri bazike të funksionimit të ekonomisë së tregut që duhet t'i zotërojnë një qytetar mesatar kur ai të futet në forcën punëtore. Si konkluzion mund të themi se duhet të angazhohemi që tani, (jemi të vonuar në këtë aspekt) dhe të gjithë aktorët vendimmarrës duhet të punojnë për të siguruar një vend të caktuar në kurrikulat shkollare për njohuritë dhe edukimin ekonomik, me kohë të konsiderueshme në klasë dhe të jemi të përkushtuar ndaj mësimit cilësor të njohurive ekonomike. Në këtë këndvështrim, po aq e rëndësishme janë programet e trajnimit të mësuesve. Për fat të keq, shumica e mësuesve të shkollave të mesme janë të patrajnuar për t'u mësuar ekonominë dhe financat personale nxënësve.

Çfarë duhet bërë ndryshe për zgjidhjen e situatës profesore?

Theksojmë se, nuk mjafton që edukimi të prodhojë individë të tillë që vetëm dinë të lexojnë, të shkruajnë dhe të llogarisin. Arsimi duhet të jetë transformues dhe të sjellë vlera të përbashkëta në jetë. Duhet të theksojmë, gjithashtu, se, shkollat si institucion i rëndësishëm dhe tempulli i dijes, ndikojnë më shumë në edukimin e individëve në një mënyrë më të qëndrueshme se sa pothuajse çdo institucion tjetër, publik apo privat. Edukimi qytetar që në bankat e shkollës ka si qëllim përgatitjen e të rinjve si qytetarë të ardhshëm për jetën qytetare aktive dhe për këtë arsye ato duhet të ofrojnë atyre njohuri, shkathtësi dhe qëndrime për t'u angazhuar aktivisht në jetën shoqërore, duke gërshtuar në mënyrë harmonike mësimin me praktikën.

Në këtë aspekt, pjesëmarrja qytetare dhe parimet demokratike duhet të përfshihen në të gjitha aspektet e shkollës. Një rol të rëndësishëm kanë dhe duhet të luajnë në këtë drejtim qeveritë studentore, shoqatat prindër-mësues, administrata e shkollës, organizatat joqeveritare që merren me politikën arsimore dhe edukimin qytetar. Të gjithë aktorët - studentët, prindërit, mësuesit, administratorët, hartuesit e programeve dhe krijuesit e politikave - duhet të kuptojnë se iniciativat për hartimin dhe zbatimin e edukimit qytetar duhet të jenë një proces i vazhdueshëm dhe përsëritës. Për në këtë aspekt politikë, kurrikulat dhe nisimat në edukimin ekonomik qytetar nuk duhet të jenë statike, por duhet të jenë

dinamike dhe të zhvillohen në bazë të kërkesave të kohës.

A e luajnë këtë rol të edukimit ekonomik qytetar shkollat tona sot? Vështirë se mund të japim një përgjigje pozitive për këtë pyetje.


Sipas jush, cili mund të jetë përkufizimi apo cilët mund të jene kriteret që e bëjnë një qytetar të edukuar dhe të mirinformuar në një shoqëri demokratike?

Qytetarin e edukuar dhe të mirinformuar do ta konceptojmë "qytetar i mirë" i cili karakterizohet nga disa tipare të rëndësishme që mendoj se janë: inteligjenca qytetare. Me këtë tipar kam parasysh se qytetar i mirë duhet të demonstrojë se zotëron njohuri dhe informacion të mjaftueshëm ekonomik, politik dhe shoqëror, zotëron mendimin kritik, di të bëjë analiza dhe të nxjerrë konkluzione për situata të ndryshme të jetës shoqërore, di të vlerësojë të interpretojë dhe të mbajë qëndrime kritike, është i aftë të shprehë mendime dhe të përfshihet në debate konstruktive, di të dëgjojë dhe të respektojë mendimin e të tjerëve. Pjesëmarrja qytetare: një qytetar i mirë është aktiv në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore të vendit, angazhohet në dialog me të tjerët, di të punojë në grup dhe të ndërveprojë me të tjerët për të ndikuar në ndryshime, janë aktivë në procesin zgjedhor, dinë të organizohen dhe të demonstrojnë në mënyrë dinjitoze. Qytetar i mirë merr pjesë në mënyrë aktive duke përfshirë edhe jetën politike, por nuk është e mjaftueshme vetëm për të votuar në mënyrë rutinore çdo katër vjet. Disponimi qytetar: Një qytetar i mirë gjithmonë demonstroi:

përgjegjshmëri, tolerancë, respekt dhe vlerësim të mendimit ndryshe, kundërshtim ndaj dhunës; shqetësim për mirëqenien e të tjerëve dhe lirinë e tyre; dëshirë për përfshirjen në aktivitetet e komunitetit dhe ndjenjën e përkatësisë në të; gatishmëri për të sakrifikuar përfitime personale për të përmirësuar atë të komunitetit ku bën pjesë. Duke theksuar këto tipare të "qytetarit të mirë": inteligjencën qytetare, pjesëmarrjen qytetare dhe disponimin qytetar, rezulton se, edukimi i qytetarit është i lidhur me edukimin e karakterit të individit-qytetar. Vitaliteti dhe qëndrueshmëria e mënyrës të jetës sonë demokratike varen nga të gjithë individët që edukohen dhe zhvillohen si qytetarë të përgjegjshëm dhe të kujdesshëm, që respektojnë veten, të tjerët dhe botën, komunitetin në të cilën jetojnë. Edukimi i karaktereve është proces përmes të cilit qytetarëve u ofron mundësi për të mësuar dhe demonstruar parimet demokratike dhe vlerat thelbësore etike siç janë përgjegjësia qytetare, ndershmëria, integriteti dhe vetëdisiplina dhe vetëkontrolli.

Sa të lidhura janë tiparet e sipërpërmendura me njëra-tjetrën?

Të gjitha këto tipare janë të lidhura ngushtë me njëri-tjetrin, dhe në themel të tyre qëndron reflektiviteti ose mendimi dhe veprimi reflektiv. Reflektiviteti nënkupton përdorimin e aftësive metakognitive, aftësive kreative dhe marrjës së një qëndrimi kritik, duke u mundësuar individëve të arrin një nivel përkujdesje sociale që u lejon atyre të distancohen nga presionet sociale, të bëjnë gjykim të pavarur dhe të marrin përgjegjësinë për veprimet e tyre.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje një pajisje UPS për nevojat e një "Server Room" të Bankës së Shqipërisë"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 8,700,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallit", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje një pajisje UPS për nevojat e një "Server Room" të Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **17 Maj 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Importonin heroinë të pastër nga Irani për në Greqi, arrestohen 5 persona

Ditën e martë janë kryer tre operacione paralele nga drejtoria policore e Atikës, sektori kundër trafikut të Drogës, sipas deklaratës së drejtorit të përgjithshëm, Jeorgios Kanelos. Shumica e të arrestuarve janë shtetas shqiptarë. Në operacionin e parë, drejtoria e policisë së Atikës kundër Drogës ka shpartalluar një bandë ndërkombëtare kriminale, e cila importonte heroinë të pastër nga Irani për ta përpunuar në Greqi si dhe kokainë e kanabis dhe shpërndarë më tej në tregun vendas. Në bashkëpunim me sektorin special antiterrorist dhe qenin e policisë ditën e martë para-ditë është zhvilluar një operacion i gjerë në mjaft zona të Athinës qendrore si Ilion, Zofria, Kipseli, Dhafni dhe Sepolia, gjatë të cilit u arrestuan 5 shqiptarë të moshave 28,31,31,35 dhe 53 vjeç, për të cilët u hapën dosjet penale. Paralelisht, policia zbuloi se kokat e bandës janë dy shqiptarë të tjerë të burgosur në Greqi. Rol qendror në importimin e heroinës së pastër nga Irani kishte 53-vjeçari shqiptar ndërsa droga e sekuestruar nëpër depot e Athinës dhe konsiderohet të kishte të ardhura mbi 1 milion euro. Gjatë operacionit u zbuluan depot, 2 laboratorë me të gjitha pajisjet si dhe u sekuestruan 44 kg e 475 gr heroinë, 10 kg e 800 gr pluhur për bastardimin

Kapet banda e shqiptarëve në Greqi, sekuestrohen 3 mln euro drogë

Zbulohen depo e laboratorë, drejtuesit ishin në burg



Jeorgios Kanelos, drejtori i përgjithshëm i antidrogës në Greqi

e lëndëve narkotike, pistoletë, automjete, motora, celularë. Në një tjetër operacion të policisë të Atikës, ditën e martë u arrestuan në Elefsina, në autostradë, një 46 vjeçar shqiptar; për transportin e 75 kg dhe 100 gr kanabis të papërpunuar. Në

vijim të operacionit, u arrestua një tjetër shqiptar 37 vjeç, në shtëpinë e të cilit u gjendën 732 kg dhe 660 gr kanabis e papërpunuar, si dhe në një tjetër depo u sekuestruan 7 kg dhe 435 gr kokainë dhe 10 kg kanabis, bashkë me 3 peshore

dhe 6 celularë dhe 540 euro nga tregtia e drogës. Policia greke deklaroi se fitimet nga shitja e sasisë së drogës së sekuestruar, gjithsej 817 kg dhe 720 gr, edhe në këtë rast mendohet të tejkalonte 1 milion euro. Në operacionin e tretë të ditës së martë, policia e Pireut ka arrestuar 13 anëtarë të një bande kriminale dhe janë në kërkim të dy akoma, të akuzuar për trafik lëndësh narkotike në tregun vendas. Arrestimet janë kryer në zona të ndryshme, Pire, Nikea, Koridhalo, Keracini dhe Korinth. Të dhënat e të arrestuarve nuk janë identifikuar plotësisht, por burime policore bëjnë fjalë për një numër të madh shqiptarësh, mes anëtarëve të bandës. Gjithsej, u sekuestruan 10 kg e 657 gr kanabis, 84 gr kokainë dhe 51 fidanë ujorë kanabis, bomba dore si dhe peshore.

Itali/ Vdes shqiptari në aksident, i vëllai në gjendje kritike

Një aksident tragjik i ka marrë jetën dhe një shqiptari në Itali, ndërsa dy të tjerë kanë mbetur të plagosur pasi makina e tyre doli nga rruga dhe u përplas me një pemë. Siç raportojnë mediat lokale, aksidenti ndodhi këtë të mërkurë në rrugën Kennedy, në Pianvallico të Firences. Viktimë e aksidentit ka mbetur një 26-vjeçar, ku mediat fqinje e identifikojnë vetëm me iniciale K.E, ndërsa dy të plagosurit janë përkatësisht 19 dhe 26 vjeç. Mësohet se njëri prej të plagosurve është vëllai i viktimës. Ata janë transportuar me urgjencë drejt spitalit dhe ndodhen në gjendje kritike për jetën.



Kontabilistë! Sigurimi i jetës është

bilanci më i sigurt i jetës suaj!



Me Sigurimin Jetë me Mbijetesë keni përfitim dyfish: sigurim jete dhe investim afatgjatë. Mbroni pasardhësit tuaj në rast të të papiturave dhe njëkohësisht investoni me një normë të garantuar interesi prej 1.2% në vit, në monedhat Lek, Euro ose Dollar. Primi vjetor minimal duke filluar nga 200 euro/vit dhe shumë sigurimi deri në 120,000 euro!



Sigurim për Jetën



Sigurim nga Aksidentet



Sigurim nga Sëmundjet Kritike

SiCRED
Shoqëri Sigurimi Jete

Për të blerë policën, kontaktoni me SiCRED në: Tel: +355 4 22 37 549 | Cel: +355 69 20 84 026 | e-mail: shitje@sicred.com.al

Ndryshojnë sipërfaqet e truallit për personat që kanë ndërtuar pa leje

Vendimi i qeverisë, 1000 pronarët që marrin tapitë

Përfituesit në Tiranë, Elbasan, Kukës, Vlorë e Gjirokastrë

Publikohet lista me rreth 1000 pronarë, të cilët marrin tapitë për tokën mbi të cilën kanë ndërtuar pa leje. Qeveria ka miratuar listën me sipërfaqet e llogaritura dhe lista është publikuar dje në Fletoren Zyrtare. Nga ndryshimet e sipërfaqeve preken disa pronarë brenda një sipërfaqeje prone. "Gazeta Shqiptare" boton listën e plotë të dosjeve, ku ka më shumë se një pronar dhe sipërfaqet për të cilat u njihet e drejta e pronës. Përfituesit janë të shpërndarë në disa qarqe të vendit, në Tiranë, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Vlorë, Berat, Kukës, Korçë, Lushnjë, Lezhë, Sh-

kodër, Dibër dhe Durrës. Deri në momentin e regjistrimit të ndërtimit të legalizuar, Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, sipas vendimit, nuk duhet të kryejnë ndryshime të gjendjes juridike të pasurive të listuara në këtë vendim.

KALIMI I PRONËSISË

Ligji i ri i legalizimeve parashikon që kalimi i pronësisë për objektet me funksion banimi të bëhet për sipërfaqe deri në trefishin e bazës, por jo më shumë se 500 m². Për sipërfaqet deri në 300m², toka do të paguhet me gjysmën e vlerës

së tregut, por jo më shumë se 2000 lekë/m² për zonat urbane dhe 1500 lekë/m² për komunat. Veç kësaj, në ligjin e ri janë përcaktuar edhe disa lehtësi të tjera në pagesën e faturës për tokën e zënë. Kështu, për pagesat e menjëhershme aplikohet 20 për qind zbritje. Ndërsa brenda 6 muajve nga data e tërheqjes së faturës, 50 % e saj mund të paguhet me letra me vlerë. Një tjetër zbritje që aplikohet është ajo me 10% që bëhet për faturat e energjisë elektrike. Për të përfitur nga ky reduktim shtesë, familjet kanë detyrimin që të kryejnë rregullisht pagesat e dritave përgjatë një viti kalendarik.

ISHTE / BEHET	NR. B.PRONAREVE	EMER	ATESI	MBIEMER	NR. PRONAVE	QARKU	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISE	SIPERFAQJA TAKUERE PER KOMPESIM (m ²)	VLERAE TREGUT PER TRUALL (lek/m ²)	VLERAE SHPERBLIMIT (lek)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

V.K.M. nr. 389, datë 19.05.2010

QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8521

ISHTE	18	ARIF	HAXHIYMER	KOÇANI	32	L Konf Labinoiti Elbasan	8521	13/14	283.2	10,000	2,832,000
	9	& (TRASHEGIMTARET)									
	0										
BEHET	1	NADJIE	HAXHI	KOÇANI	1	Lagja "Konferenca Labinoiti", Elbasan	8521	13/14	161.6	10,000	1,616,000
	2	ALEMSHA	HAXHI	KOÇANI							
	3	ARIF	HAXHI	KOÇANI							
	4	PETRI	HAXHI	KOÇANI							
	5	BURBUQE	HAXHI	KOÇANI							
	6	MIMOZA	HAXHI	KOÇANI							
	7	SHËGUSH	HAXHI	KOÇANI							
	8	MIGËNA	HAXHI	KOÇANI							

V.K.M. nr. 378, datë 25.05.2016

QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8526

ISHTE	806	GEZIM	KAMER	MERKO	104	ELBASAN	8526	383/1/29	546.6	12,764	6,976,802.4
Behet	8	GEZIM	KAMER	MERKO	2	ELBASAN	8526	383/1/29 (383/104)	516.4	12,764	6,591,329.6

V.K.M. nr. 529, datë 20.07.2016

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 1649

ISHTE	528	FAIK		ALLUSHAJ	79	TIRANE	1649	19/33	195.4	324	63,309.60
BEHET		ANULLOHET			3	ANULLOHET			ANULLOHET		

V.K.M. Nr. 563, datë 29.07.2016

QARKU SHKODER, ZVRPP SHKODER, ZONA KADASTRALE 1139

ISHTE	455	MARK		GJONI	68	SHKODER	1139	341/1	365.0	293	106,945
BEHET	10	MARK		GJONI	4	SHKODER	1139	341/1	100.0	293	29,300

KATEGORIA	Nr. nendë	Të dhënat e Pannosit në Legjislacion							Kompensimi i Pronësive							Shtetësi i Tregut	
		Emër	Atësi	Mbiemër	Laja e legjislacionit		Gjendja juridike (pronësi)	Pjesa tokësore në parcelë (m ²)	Sipërfaqja për kalimin pronësisë (m ²)	Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pannosit	Masa e kompensimit (m ²)	Qëndri (lek/m ²)		Shuma (Vlera e kompensimit)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18

VKM nr 230, datë 21.02.2017

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 928

ISHTE	MIRZA		TOSHAL		ZENELI		678		26.04.2011		IRAHIM		CULLAJ		6774	476.20	2370	11,263,886					
		IRAHIM	IRAHIM	IRAHIM	IRAHIM	IRAHIM	IRAHIM	IRAHIM	IRAHIM	IRAHIM	IRAHIM	IRAHIM	IRAHIM	IRAHIM					IRAHIM				
		SULTANE	SULTANE	SULTANE	SULTANE	SULTANE	SULTANE	SULTANE	SULTANE	SULTANE	SULTANE	SULTANE	SULTANE	SULTANE					SULTANE				
		EDRIP	EDRIP	EDRIP	EDRIP	EDRIP	EDRIP	EDRIP	EDRIP	EDRIP	EDRIP	EDRIP	EDRIP	EDRIP					EDRIP				
		EDROFEP	EDROFEP	EDROFEP	EDROFEP	EDROFEP	EDROFEP	EDROFEP	EDROFEP	EDROFEP	EDROFEP	EDROFEP	EDROFEP	EDROFEP					EDROFEP				
		LITPI	LITPI	LITPI	LITPI	LITPI	LITPI	LITPI	LITPI	LITPI	LITPI	LITPI	LITPI	LITPI					LITPI				
		SHENIP	SHENIP	SHENIP	SHENIP	SHENIP	SHENIP	SHENIP	SHENIP	SHENIP	SHENIP	SHENIP	SHENIP	SHENIP					SHENIP				
		EMINE	EMINE	EMINE	EMINE	EMINE	EMINE	EMINE	EMINE	EMINE	EMINE	EMINE	EMINE	EMINE					EMINE				
		FRITME	FRITME	FRITME	FRITME	FRITME	FRITME	FRITME	FRITME	FRITME	FRITME	FRITME	FRITME	FRITME					FRITME				
		SADRYTE	SADRYTE	SADRYTE	SADRYTE	SADRYTE	SADRYTE	SADRYTE	SADRYTE	SADRYTE	SADRYTE	SADRYTE	SADRYTE	SADRYTE					SADRYTE				
		HURMA	HURMA	HURMA	HURMA	HURMA	HURMA	HURMA	HURMA	HURMA	HURMA	HURMA	HURMA	HURMA					HURMA				
		VAJE	VAJE	VAJE	VAJE	VAJE	VAJE	VAJE	VAJE	VAJE	VAJE	VAJE	VAJE	VAJE					VAJE				
	RAMAZAN	RAMAZAN	RAMAZAN	RAMAZAN	RAMAZAN	RAMAZAN	RAMAZAN	RAMAZAN	RAMAZAN	RAMAZAN	RAMAZAN	RAMAZAN	RAMAZAN	RAMAZAN									
	BEKPE	BEKPE	BEKPE	BEKPE	BEKPE	BEKPE	BEKPE	BEKPE	BEKPE	BEKPE	BEKPE	BEKPE	BEKPE	BEKPE									
	GEZINA	GEZINA	GEZINA	GEZINA	GEZINA	GEZINA	GEZINA	GEZINA	GEZINA	GEZINA	GEZINA	GEZINA	GEZINA	GEZINA									
	SEVËTE	SEVËTE	SEVËTE	SEVËTE	SEVËTE	SEVËTE	SEVËTE	SEVËTE	SEVËTE	SEVËTE	SEVËTE	SEVËTE	SEVËTE	SEVËTE									

IDHETI	17	IJAZ	HYQMET	ALIBI	263358	24.05.2017	TE TRAKTIVE	BEQEF	CELINAJ	6/1004	397.00	23,703.0	940,095.00
								LITFI	CELINAJ				
								SHKUP	CELINAJ				
								EMINE	SHIMA				
								IRTIME	CELINAJ				
								SAGETE	CAJSHI				
								HERMA	CELINAJ				
								VAJE	CELINAJ				
								BAMAZAH	CELINAJ				
								KEPJE	CELINAJ				
								GEZIN	CELINAJ				
								SEKVFTE	KECI				
								SAGJE	CELINAJ				
								ZOHJ	BRIGJETA				
								SHPEESA	ISIPA				
								FLUTIRA	BAZHANA				
								KUTIM	CELINAJ				
								MIMCZA	CELINAJ				
								AGJINI	CELINAJ				
								MRELA	CELINAJ				
BARONA	CELINAJ												
SHANE	CELINAJ												
ARSHI	CELINAJ												
VOJLCA	TRIFLINA (CELINAJ)												

V.K.M. nr. 43, dat 11.07.2015

LEB@K

IDHETI	6	ANULLOHET	ANULLOHET	ANULLOHET	ANULLOHET	ANULLOHET	ANULLOHET	204	Sereta	Ripa	Dyrradas	7/1347	204.00	8,537	1,741,540.0	Diferenca sipas ligjeve te abazave dhe per korrupsionin e pergjithshem
								Titull	Ripa	Qona						
								Marta	Ripa	Qona						
								Diana	Ripa	Qona						
								Julian	Ripa	Qona						
								Propam	Ripa	Qona						
								Dakota	Ripa	Qona						
								Mason	Ripa	Qona						

V.K.M. nr. 43, dat 11.07.2015

LEB@K

IDHETI	65	SAMES	NEZIR	BEQIRI	855034	28/06/2016	FRONAR	231.5	BEQIRI	LEKA	327/1	700.2	12,794	8,927,352.8
									JOHJETA	LEKA (KREPESHITTI)				
									ARJANA	LEKA (GREGA)				
									CENO	METVISE				
									EDIT	CENO				
									SARJE	VOGLI				
									KAROLDA	ALI				
									MRELA	ALI				
									MERTJA	REJEM				
									ARDJAN	MEHMET				
									LUEJDA	RAMEZ				
									MEHMET	BEKUR				
									RYMERA	JOHJETA				
									ILIJAN	BEQEF				
									ALI	MUTTARA				
									EMAL	MUTTARA				
									ALBIRIA	SIBASHI				
									MANTISACE	SIBASHI				
									NEZIRIJE	SIBASHI				
									SUZANA	SIBASHI				
HAZME	SIBASHI													
RYMIRE	SIBASHI													
DIJEM	SIBASHI													
SHPEESA	SIBASHI													
EMERA	SIBASHI													
SEGA	SIBASHI													

QARKU ELBASAN, ZYPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 008

IDHETI	4	SAMES	NEZIR	BEQIRI	855034	28/06/2016	FRONAR	231.5	BEQIRI	LEKA	327/1	700.2	12,794	8,927,352.8
									JOHJETA	LEKA (KREPESHITTI)				
									ARJANA	LEKA (GREGA)				
									CENO	METVISE				
									EDIT	CENO				
									SARJE	VOGLI				
									KAROLDA	ALI				
									MRELA	ALI				
									MERTJA	REJEM				
									ARDJAN	MEHMET				
LUEJDA	RAMEZ													
MEHMET	BEKUR													

V.K.M. nr. 75, dat 11.07.2015

LEB@K

IDHETI	CELJEC	SKENDER	SEKIDERI	99748	22/05/2017	E te Tere	PAJDE	SHAHIN	HAMITI	14/403	501.90	22,985	11,536,171.30	REZERVICAJA E FAKTORE PER ARBE TE REGJISTRUETTE LEJES SE LEG REP HUPROVIM NR. 1035 (R.24.12.2004)
							BAJJE	SHAHIN	HAMITI					
							NACIRE	SHAHIN	HAMITI					
							RYMIR	SHAHIN	HAMITI					
							QYLE	SHAHIN	HAMITI					
							NAJJE	SHAHIN	HAMITI					
							SEKVFTE	SHAHIN	HAMITI					
							MERDJA	SHAMAL	HAMITI					
							SHEVANRE	SHAMAL	HAMITI					
							FLOKORA	SHAMAL	HAMITI					
							VLADIMIR	SHAMAL	HAMITI					
							ARJANA	SHAMAL	HAMITI					
							KLOTIDA	RAMOND	HAMITI					
							KLODAN	RAMOND	HAMITI					
							RYOS	QEMAL	HAMITI					
							MANTISACE	QEMAL	HAMITI					
							PELLERDE	QEMAL	HAMITI					
							ALMA	QEMAL	SELAJ					
							FLAMIR	QEMAL	HAMITI					
							CLJEM	AGEM	HAMITI					
							RICIARD	HAMITI	HAMITI					
							ENKELLEJDA	KAJEM	ZYREK					
							SHRIME	HAMITI	HAMITI					
							MIRYRIJE	SABR	COJJA					
							SULLTANE	SABR	HAMITI					
							CAJMETE	SABR	HAMITI					
							DALLENDYDE	SABR	HAMITI					
							ARSHI	SABR	HAMITI					
							HACJI	SABR	HAMITI					
							BAJJE	HAMITI	HAMITI					
							ARJANA	SKENDER	HAMITI					
							LEONORA	SKENDER	HAMITI					
							RYTON	SKENDER	HAMITI					

QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 001, ZYPP TIRANE

ANULLOHET ANULLOHET ANULLOHET

Del para gjykatës grupi tjetër i grave kosovare të kthyer nga Siria

Pas rikthimit në vend të kosovareve nga Siria, partia franceze e ekstremit të djathtë "Debout la France" me anë të një komunikate për mediat ka shprehur qëndrimin e saj për këtë çështje. Kryetari i partisë ekstremiste franceze Nicolas Dupont-Aignan deklaroi se në Kosovë mund të ketë edhe xhihadistë dhe ky është një rrezik real për sigurinë e Europës. Komunikata e tyre e publikuar në sajtin e tyre, deklaroi se partia do të kundërshtojë ashpër Parlamentin Evropian dhe Bashkimin Evropian në nisimat e tyre për liberalizimin e vizave dhe pranimin në BE për Kosovën. Në komunikatën e nënshkruar nga kryetari i kësaj partie shkruhet se "Kosova sot po refuzon çdo këshillim me BE-në rreth sigurisë së Evropës duke kthyer këta xhihadistë. Më tej vazhdohet edhe me se BE-ja dhe Franca duhet të ndërprisë iniciativat e nisura për hapjen e Evropës ndaj Kosovës". Partia në fjalë në shqip do të thotë "Reago Francë" dhe janë euro-skeptikë. Kjo parti ka një vend në Asamblenë Kombëtare Franceze dhe katër komuna në Francë. Ata janë aleatë të kandidatës kontraverse Marine Le Pen, Nicolas Dupont-Aignan dhe Marine Le Pen. Këta politikanë ishin mbështetur nga mediat ruse gjatë zgjedhjeve të 2017-s në

Rikthimi i xhihadistëve në Kosovë, Franca: Europa në rrezik

Deputeti francez: Po refuzojnë çdo këshillim me BE-në



Gratë kosovare të kthyer nga Siria

Francë.

Nga ana tjetër, vijnë të dalin para gjykatës grupe kosovarësh të ardhur nga Siria. Një grup tjetër i përbërë nga gjashtë gra të kthyer

nga Siria është paraqitur para Gjykatës Themelore të Prishtinës. Në seancë, prokuroria ka kërkuar vendosjen e masës së arrestit shtëpiak ndaj tyre për shkak

të dyshimit se kanë kryer veprën penale, bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose parapolice, në organizimet grupore apo individualisht jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Kimete Krasniqi, avokate e njëres nga gratë të dyshuara për këtë veprë penale, tha pas seancës se ka kundërshtuar kërkesën e Prokurorisë për vendosjen e masës së arrestit shtëpiak. "Për të mbrojtur time nuk ka asgjë që është e vërtetuar se ka kryer këtë veprë penale. Klientja ime ka qenë e mashtuar nga burri i saj tashmë i ndërjerë, i cili është vrarë pas tre muajsh të qëndrimit atje", tha Krasniqi. Grupi i parë i përbërë nga dhjetë gra u paraqit të martën para Gjykatës Themelore të

Prishtinës. Pas përfundimit të seancës, Gjykata Themelore e Prishtinës njoftoi se ka vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Speciale për caktimin e masës së arrestit shtëpiak kundër 10 grave të pandehura, me inicialet, V.B., F.D., F.L., N.H., A.Z., V.K., H.K., L.L., S.S. dhe M.A. për shkak të veprës penale bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose parapolice, në organizimet grupore apo individualisht jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Të dhjetë grave u caktua masa e arrestit shtëpiak në kohëzgjatje prej 1 muaji për secilën, duke filluar nga data 23.04.2019 deri më 23.05.2019. Gjykata tha se ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurat që nga viti

2014 e deri më 20.04.2019, kanë qenë në zonën e konfliktit në Siri dhe Irak. Prokurori Special, Sylë Hoxha, tha të martën se janë duke u zhvillur hetime ndaj 32 grave të kthyer nga Siria nën dyshim për veprën penale, bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose parapolice jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Javën e kaluar, 110 kosovare u kthyen nga Siria në Kosovë, kryesisht gra dhe fëmijë, gjithashtu edhe katër luftëtarë, të cilët u arrestuan menjëherë pas arrijtes në Kosovë. Të kthyerit u mbajtën për 72 orë në Qendrën për të Huajt në fshatin Vranidoll në periferi të Prishtinës dhe më pas u lejuan që të rikthehen në shtëpitë e tyre.



NJOFTIMI I ANKANDIT

- Autoriteti Shitës:** Albpetrol Sha Patos, Rruga Fier – Patos km 7.
- Data e zhvillimit të ankandit:** 03.05.2019, ora 11:00.
- Lloji i Procedurës të ankandit:** Procedure e hapur.
- Objekti i Shitjes:** Shitje nafte brut, sasia 75 101 ton.
- Afati i evadimit:** 270 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.
- Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes:** Shitje e nafte brut, sasia 75 101 ton.
- Vlera fillestare:**

Ne kushtet FOB:

Çmimi minimal fillestar per njësi është:

75.27 % e Çmimit Brent + K

Në pikat e lëvrimit:

Çmimi minimal fillestar për njësi është:

75.27 % e Çmimit Brent – 2.97 USD/bbl + K

- 75.27 % është koeficienti i cili përfaqëson karakteristikat mesatare të nafte (pesha specifike, aciditeti i nafte, % e squfurit).
- Brent është çmimi në \$/bbl i Brent i Platts, i publikuar në Buletinin e Prokurimit Publik.
- 2.97 USD/bbl kosto mesatare totale (transport, magazinim, stokim, analizim produkti, sigurim).

- K- është vlera \$/bbl e ofruar nga ofertuesi mbi çmimin minimal të shitjes të përlogaritur nga formula (Ke⁰).

- Vendndodhja e nafte brut: Albpetrol sha Patos:** Ne pikat e levrimit Stacioni Usoje, Stacioni Visoke, Stacioni Gorisht, Stacioni Zharrez, Stacioni Kuçove, Stacioni Amonice.
- Vendi i zhvillimit të ankandit:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Rruga Abdi Toptani Nr. 1, Kati II, Salla e Mbledhjeve, Tiranë.
- Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje:** në zyrën e protokollit Kati 1 tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, datë 03.05.2019, ora 11:00.
- Data e hapjes së ofertave:** datë 03.05.2019, ora 11:00, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Rruga Abdi Toptani Nr. 1, Kati II, Salla e Mbledhjeve, Tiranë.

12. Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentet e ankandit mund të tërhiqen pranë autoritetit shitës me paraqitjen e një kërkesë me shkrim ose në faqen zyrtare të "Albpetrol" sha www.albpetrol.al dhe në faqen e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë www.infrastruktura.gov.al.

Dokumente me pagesë:

Po Jo

- Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës në kopje fizike, me poste ose dorazi, përpara datës dhe orës së zhvillimit të ankandit, të vendin e përcaktuar në dokumentat e ankandit.**

BOTIMI

LEDI SHAMKU: Ti je gjuha që flet

Është mbajtur dje pranë Librit Akademiç të Akademisë dhe Shkencave të Shqipërisë, një tryezë diskutimi e organizuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, me temë "Studimet gjuhësore e letrare shqipe në ASA, diskutim për probleme e hapësira të reja". Të ftuar qenë prof. Alberto Manco (Napoli) dhe prof. Nicola Grandi (Bologna). Në përmblyllje të kësaj tryeze u prezantua në prani të autorit dhe libri më i fundit i gjerdanit Excipere të Botimeve Çabej "Ti je gjuha që flet; Baza të tipologjisë gjuhësore" nga Nicola Grandi. Hyrja e këtij libri është shkruar nga Ledi Shamku që po e botojmë më poshtë.

Nga Ledi Shamku-Shkreli

Ti je gjuha që flet" është ndër botimet fare të rralla teorike në shqip mbi tipologjinë gjuhësore. Afërmeqë koncepti "tipologji" gjendet në ravnimet gjuhësore albanologjike, por vetëm si term i gjuhësisë historiko-krahasuese apo asaj të arealeve. Kësisoj studiuesi deri më tash do ta ketë hasur këtë term në gjenealogjinë gjuhësore kur ka ndeshur bie fjala në tipologjitë e përbashkëta të familjes së gjuhëve indoeuropiane. Po ashtu mund ta ketë hasur edhe në gjuhësinë e arealeve, të paradigme të gjuhëve të Ballkanit, të cilat, sa pa u studiuar mirë kontaktet gjuhësore, qenë përmbledhur disa me pahir në të ashtuquajturën Lidhje Gjuhësore Ballkanike. Thënë shkurt, deri më tash në studimet tona albanologjike nuk janë kapërcyer kolonat e Herkullit sa i takon tipologjisë, pasi janë marrë në shqyrtim vetëm tiparet e gjuhëve të farefisnuara ose ato fqinje. E madje, edhe këtu është ndalur në studime krahasuese mes tipareve konkrete, pa abstraguar një model të supozuar teorik. Ndryshe nga shprehitë tona, qysh në çelje ky libër na e bën ta qartë se "te qasja tipologjike interesi i studiuesit rrok thuasje vetëm impiantin strukturor të gjuhëve: gjuhët klasifikohen mbi bazë afrish (o dallimesh) sistematiko-strukturor, pa marrë në konsideratë as familjen gjuhësore së cilës i përkasin, as daljen dhe dëshimin e tyre në histori, e madje as proceset evolutive që mund të kenë përshkuar afritë e dallimet mes tyre".

Do thënë se kjo disiplinë lindi fillimisht për t'i ardhur në ndihmë vetë gjuhësisë historiko-krahasuese, si mbrojtje nga spekulimet që po merrnin hov; fjala vjen përpjekjet e Schlegelit për të shkruar një tipologji bazë për hetimin e gjenealogjisë indoeuropiane apo profilet tipologjike të hartu-

ara nga Nikolaj Marr që i konceptonte tipet morfologjike kryesisht si stade të evolucionit në një gjuhë imagjinare të përbashkët (u?enie o stadia!nosti). Sakaq, Rrethi Gjuhësor i Pragës e kishte shpërndarë gjithkund strukturalizmin e Saussure-it, e duke u përqendruar te struktura, Sapir shkruante se "mund të themi që të gjitha gjuhët dallojnë njëra nga tjetra, por disa dallojnë mes tyre më shumë se disa të tjera. Ky vëzhgim do të thotë se mund t'i grupojmë në tipe morfologjike, po edhe në tipe fonologjike e sintaksore ...është kështu e kotë të ngulmojmë se meqë një gjuhë ka një histori të veçantë, ka doemos edhe një strukturë po kaq të veçantë". Pas këtij vëzhgimi merret me mend se baza e tipologjisë, e cila mëkëmbet aty nga vitet '50, nuk do të jetë më inventarizimi i rrëmujshtëm i të dhënave, por struktura vetë e secilës gjuhë, përfshirë ato që nuk kanë "biseduar" ndonjëherë me sho-shoqen. Kjo premisë studimore jepet bukur qartë qysh në faqet e para të këtij libri, ku autori shkruan se "për tipologjinë gjuhësore karakteristika individuale nuk janë relevante në vetvete - në këtë rast në fakt jemi ende në një nivel thjesht deskriptiv - por e qenësishme mbetet ratio e thellë që shpjegon ballafaqimin mes tyre".

Çështje kjo ratio e thellë që kërkon të zbulojë tipologjia? Ç'ka gjuhësore e jashtëgjuhësore në të? Afërmeqë struktura sistematike e një gjuhe ka mjetet e veta morfologjike, sintaksore e fonologjike, dhe të gjitha këto i përdor kryesisht për të komunikuar, jo thjesht për të informuar. Shtyja komunikuese, si shtyjsë parësore e gjuhëve historiko-natyrore, u përcaktonte strukturave dhe rendeve ligjëriore një funksion të qartë semantike. Kjo do të thotë se tipologjia si disiplinë u përbahet parimeve të funksionalizmit, përpos atyre të strukturalizmit, përndryshe studimi i strukturës do ta bjerrte kuptimin. Ka gjasa që kjo ratio e thellë që ndërmend autori i këtij libri të jetë pikërisht funksioni. Mirëpo funksioni është një shtyjsë sa gjuhësore aq edhe jashtëgjuhësore, e më tej akoma, shtyja gjuhësore veç tjerash është sa konjitive aq edhe sociale. Stadi i sotëm i gjuhësisë, me disiplinat kapërcylore që i përkasin, ka rishikuar edhe konceptin e funksionit të gjuhës. Lidhur me këtë të fundit, siç vëren edhe Schleiernacher, "çdo njeri është nën pushtetin e gjuhës që flet. Ai vetë dhe gjithë mendimi i tij janë produkt i

Shënime për librin e Nicola Grandit që u promovua dje në Tiranë



kësaj të fundit". Nëse deri dje është besuar se gjuha duhet për të shprehur mendimin, sot ky pohim po rezulton i mangët. Pa i hyrë garës kohore "në fillim gjuha apo mendimi?", sot është e qartë se shumekush mendon në një gjuhë të caktuar, e madje i ruan pjesërisht skemat e arketipit gjuhësor edhe kur kërkon të shprehet në një tjetër gjuhë. Me fjalë të thjeshta, funksioni i gjuhës nuk zë fill të shprehja e mendimit, por te vetë mendimi. Del se duhet gjuha për të menduar, e mandej edhe për t'i komunikuar mendimet e ndjesitë tona.

Gjithë sa thamë mbi funksionin e gjuhës dhe lidhjen e saj me mendimin na afron me hipotezën e relativizmit gjuhësor të Sapir-

Whorf, e cila e përmbledhur me fjalë të thjeshta do të tingëllonte pak a shumë si titulli i këtij botimi: çdokush është gjuha që flet. Lidhur me këtë fuqi të gjuhës Whorf shkruan: "Bota përshfaqet si një shtjellë kaleidoskopike mbresash, të cilat duhet të organizohen nga mendjet tona, madje për ta thënë më saktë nga sistemet gjuhësore që kanë mendjet tona. Ne e ndajmë në copëza natyrën, mandej copëzat i shndërrojmë në koncepte, e sakaq u mvshim edhe kuptimësi; gjithë kjo ndodh ngaqë jemi pjesë e një marrëveshjeje për ta organizuar botën në këtë mënyrë; një marrëveshjeje fuqplotë brenda bashkësisë sonë gjuhësore, të cilën e kanë kodifikuar skemat e gjuhës

sonë".

Kush rrëmon te ky citim, në dukje i thjeshtë i Whorfit, ka gjasa të gjejë jo vetëm tri nocionet bazë të tipologjisë si disiplinë gjuhësore, po edhe tharmin e rifuzimit të saj për kohërat që e presin. Tri nocionet tipologjike bazë që gjenden te ky citim janë: sistem gjuhësor, organizim strukturor dhe bashkësi gjuhësore.

Le të përqendrohemi një hop te kjo e fundit, pra te bashkësia gjuhësore si një koncept i debatuar për më se një shekull, duke u shtyrë gjithnjë drejt përimtimit të elementeve që e plazmojnë. Përcaktimi i Labovit (1972) se bashkësia gjuhësore përftohet nga përfshirja e përdoruesve në një tërësi rregullash të përbashkëta, të cilat formojnë tipe të qarta në "njëtrajtësinë e skemave abstrakte të variacionit", sot rezulton i pamjaftë dhe disi i ngurtë për t'u përgjigjur larmisë së varianteve të përshkuara ndër vite.

Për gjuhësinë e cila shkon gjithnjë e më në detaj, një koncept tashmë gjenralizues i bashkësisë gjuhësore të Labovit konkurrohet sot nga koncepti i bashkësisë së përdorimit (community of practice) i përcaktuar nga Eckert. Sipas Eckert, në bëhemi pjesë e një bashkësie sa herë përdorim një variant të caktuar nga repertori i një gjuhe (në bazë të situatës, marrësit, kumtit etj.). Me fjalë të thjeshta, në një shoqëri gjithnjë e më të arsimuar, kompetenca komunikuese (jo ajo gjuhësore) krijon bashkësitë e përdorimit, të cilat mund të jenë me miliarda, por që sigurisht kanë qendrat e tyre fokale e të konvergjitimit. Te këto qendra vlen të studiohen karakteristikat e qenësishme të tipeve variacionale. E pikërisht koncepti i bashkësisë së përdorimit mund t'i kërkojë tipologjisë gjuhësore të zgjerojë objektin e saj të studimit. Nicola Grandi na bën me dije këtu se "tipologjia gjuhësore merret kryesisht me studimin e variacionit ndërgjuhësor (interlinguistik)", por, nebulozja e varianteve që riprodhohen vazhdimisht prej bashkësive të përdorimit i sugjeron tipologjisë edhe variacionin brendagjuhësor (intrainguistik), duke ndërtuar më pas modele përshkruese teorike të tipeve variacionale.

Zgjerimi i objektit të tipologjisë drejt variacionit brendagjuhësor veç tjerash do ta përkrahente më saktë jo vetëm sinkroninë po edhe diakroninë e secilës gjuhë të shqyrtuar. Kjo pasi krahasimi i një gjuhe me një tjetër, për vetë

FILMI

Filmi i parë shqiptar në Kanë, Erenik Beqiri: Si u realizua "The Van"

Fatmira Nikolli

Një ndër faktorët kryesorë për shkrimin e skenarit dhe më pas realizimin e filmit, është 'nevoja' e shoqërisë shqiptare për të emigruar, në kërkim të një të ardhmeje më të mirë. Kudo që shkon dhe pyet, nëpër shoqëri, shumica e tyre e shprehin këtë dëshirë për të ikur nga Shqipëria. Mendoj që ky ka qenë faktori kryesor në realizimin e filmit". Erenik Beqiri e shpjegon me këto fjalë për "Gazeta Shqiptare" shtysën që e çoi të realizonte filmin "The Van". Me këtë prodhim të një të riu shqiptar, Shqipëria shënon herën e parë që një film shqiptar arrin të bëhet pjesë zyrtare e Festivalit të Kanës. "Besoj që pas këtij festivali, filmi do udhëtojë edhe nëpër festivale të tjera në botë", thotë Beqiri. Në të interpretojnë aktorët Arben Bajraktari, Afrim Muçaj dhe aktori francez 27 vjeçar, Phénix Brossard. "Kanë, ja tek po vijmë! Faleminderit çdokujt që na qëndroi pranë. Krenarë që jemi shqiptarët e parë që marrim pjesë në garën zyrtare", shkruan Erenik Beqiri, autori i filmit që do të përfaqësojë Shqipërinë në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit me Metrazh të Shkurtër.

"Filmi flet për një djalë rreth të 20-ve i cili ka si qëllim të emigrojë jashtë vendit. Në mënyrë që të fitojë lekët e duhura sa me shpejt, ai pranon të bëhet pjesë e disa



Regjisori: Shtysë ishte nevoja e shqiptarëve për të ikur nga vendi

ndeshjeve që zhvillohen brenda një furgoni. Rregullat e furgonit janë të thjeshta, dyert mbyllën dhe furgoni nisat në një trajektore rutinë, duke u kthyer në pikën e nisjes. Dyert hapen dhe nga aty mund të dalë vetëm një fitues", tregon Beqiri.

Furgoni (The Van) është një

prodhim shqiptaro-francez, i realizuar me fonde Franceze. Xhirimet e filmit janë kryer në fillim të muajit Janar të këtij viti dhe në Shkurt filmi mbylli post-produksionin në Paris.

Ai është film me metrazh të shkurtër dhe ka rrugëtimiti i tij ka nisur në vitin 2016 në European Short Pitch.

Më herët, Beqiri ka marrë pjesë në Tiranë Gilm Festival me filmin "Bon Appetit" për të cilin do të shprehej se "një burrë i uritur për pushtet, gjen një mënyrë të re për të kënaqur oreksin e tij", film i cili është shfaqur edhe në Kanada.

Në filmin e parë interpretimin aktorët Romir Zalla, Arben Bajraktari dhe Ema Andrea.

"Bon Appetit" numëron disa çmime nga festivale të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare. "Bon



Appetit' ka në qendër një burrë, që ecën nëpër tunelet e errëta të një ndërtese të braktisur deri sa e gjen një tryezë që po e priste dhe kamerierin e gatshëm për ta shërbyer me darkën speciale të bërë vetëm me mish njeriu. Një sfidë për oreksin e tij.

Ai është shfaqur edhe në International Film Festival në Francë. Në Frostbiter: Icelandic Horror Film Festival "Bon Appetit" është shpallur filmi më i mirë i shkurtër i huaj në një garë ndërkombëtare. Ai është shfaqur edhe në Ithaca Film Fest, Festival de Cortos de Bogotë - BOGOSHORTS, në Toronto, në Lund International Fantastic Film Festival, ndërsa në Festivalin e Tetovës ka fituar çmimin "Best cinematography".

← dimensionin që gjuhët kanë, nxjerr në pah strukturën përfaqësuese të secilës gjuhë, por nuk arrin të vërejë tiparet variabël të saj, jo dhe aq të dukshme, por po aq të rëndësishme sa ato përfaqësuese. Në vijim të metaforës së syzeve që Grandi përdor në libër kur vëren se "tipet janë syzet përmes të cilave gjuhëtarët zhbirlojnë gjuhët", mund të pohojmë se krahasimi brendagjuhësor ofron syze më të fuqishme për detaje më të imëta që dalin nga përshkrimi i stadeve brenda një gjuhe të vetme; e cila, në fakt, nuk është kurrë e vetmuar, si rezultat historik i një komunikimi ndërgjuhësor e brendagjuhësor.

Për kohën kur hodhi shtat tipologjia, shtegu ndërgjuhësor përveçse i nevojshëm ishte edhe i kushtëzuar; disiplina përshkruaruese që studionin dhe dokumentonin pa paragjykim faktet gjuhësore në repertor të një gjuhe sapo kishin nisur të seliteshin. Sikundër vëren Grandi, "të pak-tën në fazën e parë të hulumtimit tipologjik, zgjidhen pothuajse gjithnjë ato gjuhë për të cilat ekziston dokumentimi (studimet shkencore, gramatika, fjalorë, etj.)... Deri disa dekada më parë

kjo ishte në fakt një zgjedhje e detyruar". Për syrin e një sociolinguisti kjo "zgjedhje e detyruar", ofruar nga gramatika e fjalorë, parakupton se korpusi i krahasuar nuk është në fakt gjuha, po thjesht varieteti i normuar i saj. Ndikimet a përkimet gjuhësore, për vëzhgimin e të cilave tipologjia na shtyn ta lemë mënjë lexikon e të kërkojmë në sferën e morfologjisë e të sintaksës, vështirë se hasen te një varietet standard tipologjikisht i pashtenjuar (neutër); mirëpo analiza tipologjike e këtyre ndikimeve a përkimeve do ishte në fakt

"legjenda" që ndihmon leximin e hartës së popujve e të kulturave. Ne jemi gjuha ase gjuhët që flasim.

Le të vërejmë kësodore shqipen. Studiuesit e historisë shqiptare e të zhvillimeve tona, pohojnë se pozicioni ynë i përherëshëm ka qenë ai mes Perëndimit e Lindjes, herë si limer i paqtë takimesh e herë si arenë e zjarritë ndëshjesh. A e dëshmon gjuha këtë pozitë kufitare?

Para se të formulohet tipologjia e mirëfilltë gjuhësore, pararendësja e saj, tipologjia e arealeve, e pat bërë shqipen

kryekëput pjesë të një modeli teorik të sforcuar, të quajtur Lidhja Gjuhësore Ballkanike. Dihen pak a shumë tiparet kryesorë të kësaj Lidhjeje, shumica me trajta lindore. Mirëpo Shqipja, nëse këqyret në repertorin e saj të përdorimeve, e jo thjesht në një varietet të vetëm, atë standard, dëshmon modele sa lindore aq edhe perëndimore. Kësisoj, është me interes të vërehet paradigma e saj e kohës së ardhme (futuri). Modeli latin popullor i së ardhmes perifrastike "amare habeo" i cili i ra ndesh futurit sintetik klasik "amabo", dha më pas italishten "amerò" dhe u zhduk. Në të folmet gegë të shqipës e gjejmë këtë model si ndikim prej latinishtes së vonë, në konstruktë si: kam me shkue, kam me thanë, të cilat kanë funksion gramatikor ardhmor. Po të rrëmojmë te ars-bëshët, do vërejmë se zbehja e fortë e paskajores si model lindor, solli në të folmet e tyre (poedhe në malësitë e Labërisë së sotme) një model hibrid perëndimor+lindor, ku ruhet konstrukt perëndimor, por brenda tij paskajoria zvendësohet me lidhore (model lindor), duke dhënë një tip hibrid futuri kam të shkoj, kam të

them.

Duke u shtyrë më tej ne hapë-sirë dhe kohë, shfaqet një tip i tretë futuri, krejtësisht lindor, sot gjithkund i përhapur: do të shkoj, do të them (do + lidhore). Modeli perëndimor i llojit kam me dalë, sot është aktiv - porse jo neutër për nga pikëpamja sociolinguistike - kështu që del vetëm pas një vëzhgimi brendagjuhësor nga mendje të mësuara me vëzhgime ndërgjuhësore, sikundër janë tipologët.

Në këtë hulli shqipja ka shumë për të përfutuar. Metafizika e objektit të studimit nuk i shkon për shtat dinamikës së zhvillimeve ligjërimore, aq më tepër sot me këtë shpërthim komunikimesh virtuale.

Vështirimet tipologjike brendagjuhësore mund të jenë një jetë e re për tipologjinë. Sausurre kishte të drejtë: gjuhësia ka si objekt të vërtetë e të vetëm gjuhën, të studuar në vetvete dhe për vetvete. Një shekull pas tij, kushdo që u qaset punëve të ligjërimit njerëzor, ka vetëdijen se asnjë gjuhë nuk është e vetmuar, edhe kur studiohet në vetvete e për vetvete, mjaft të lexohen qartë trajtat origjinale të tipeve.

Shtysa komunikuese, si shtysë parësore e gjuhëve historiko-natyrore, u përcakton strukturave dhe rendeve ligjërimore një funksion të qartë semantik. Kjo do të thotë se tipologjia si disiplinë u përmbahet parimeve të funksionalizmit, përpos atyre të strukturalizmit, përndryshe studimi i strukturës do ta bjerrte kuptimin. Ka gjasa që kjo ratio e thellë që ndërmend autori i këtij libri të jetë pikërisht funksioni.

Opinion

i Ditës

Nuk ke ku shkon pa folur me "armikun"!

Nga Skënder Minxhozi

(vijon nga faqja 1)

... i përgjigjej Lulzim Basha në 11 prill nga Vlora, ftesës formale që Edi Rama i kishte bërë për të nisur një dialog për zgjidhjen e krizës së mandateve. Janë dy fjali, të cilat shumëkush i dëgjon disa herë në ditë përmes mediave dhe që janë kthyer në moton qendrore të protestave opozitare që nga muaji shkurt.

Janë gjithashtu dy fjali, të cilat përmbledhin një koncept që s'ka Zot ta zbërthëjë dhe që përbën de facto paradoksin dhe hallakatjen logjike, me të cilën vepron sot opozita e dalë rrugëve. Në frazën e parë Lulzim Basha njofton se nuk do të ketë dialog me Edi Ramën (lexo: sepse ma punoi një herë në kohën e çadrës). Është qëndrimi i frikësuar e kapitullues i politikantit, që e di se do ta humbasë përballjen qysh në krye të herës. Që e ka të qartë se po shkojë në tryezë me kundërshtarin politik (gjëja më normale e botës në një ambient politik), do të dalë si rruar qethur prej andej.

Largimi apriori i Bashës nga detyra e dialogimit me palën tjetër, detyrë që e ka për shkak të pozitës që mban dhe asaj që përfaqëson zyrtarisht, na zbulon për të disatën herë një politikan të frustruar nga e shkuara e tij politike, por edhe të pazotin për t'u bërë ballë kthesave e gropave thithëse që momentet e vështira si ky aktual, i nxjerrin para një lideri politik. Krizën e tij personale përballë Ramës, Lulzim Basha preferon ta shtrijë, duke e bërë krizë të të



gjithë panelit që drejton. Nuk flasim se ai na e hedh! Kapitullim pa hapur ende gojën, me fjalë të tjera...

Në frazën e dytë, Basha e bën edhe më të thellë rrëmuajtën ku e ka futur me duart e tij të gjithë procesin politik në vend. Kërkon largimin e panegociueshëm të Edi Ramës, por bën sikur harron se edhe largimet negociohen. Edhe ato "pa kushte" madje. Të gjitha konfliktet e mëdha e të përgjakshme botërore kanë pasur në fun-

din e tyre negociata palësh që janë vrrarë e prerë mes tyre, por që në fund janë ulur të flasin. Dhe për gjithçka, për të gjitha fobitë, dyshimet dhe mëdyshjet e Lulzim Bashës kur bëhet fjalë për t'u ulur përballë Ramës, fajin e ka 17 maji 2017. Ajo ditë e mallkuar, kur negocioi me Ramën kalimin e këtij të fundit në minorancë në qeverinë që drejtonte, duke kujtuar se e futi në qoshe dhe i mori zgjedhjet. Ajo ditë e "flamosur", kur Basha kujtoi se fitoi gjithçka, për të kuptuar

një muaj e gjysmë më pas se kishte humbur gjithë çfarë kishte në xhepa, ka krijuar një mosbesim patologjik brenda të gjithë opozitës, e më së pari brenda personit të kryetarit të saj.

Lulzim Basha dhe krerët politikë që i shkojnë pas në këto orë po kërkojnë të ribëjnë të gjithë panelin që kanë përballë, vetëm mbi bazën e ultimatumëve dhe largimit të vazhdueshëm nga të gjitha procedurat që bota demokratike ka krijuar për të

zgjidhur mosmarrëveshjet brenda sistemit politik. Sa më keq aq më mirë, duket sikur thonë në kor opozitarët, duke kërkuar ikjen e Ramës, por jo zgjedhje të parakohshme, rregulla të reja elektorale, por pa dhënë asnjë koordinatë se çfarë duhet të jenë ato, dënimin e korrupsionit e të trafikantëve të drogës së infiltruar në politikë, por duke penguar e bllokuar me të gjitha mjetet reformën në drejtësi. Paradoxe dhe kundërtënie në çdo hap, të cilat në fakt përmbledhin gjendjen funksionale në të cilën ndodhet sot "aksioni sublim" i djegjes së mandateve.

Në tre muaj pas këtij autogoli të hatashëm, opozita shqiptare vijon të endet pa busull në kallamishet e krizës që krijoi. Tani që për mandatet e djegura flitet thuhet ekskluzivisht vetëm në emisionet e debatit në darkë apo në fletshet informative, Basha dhe të tjerët e kanë marrë vesh se pranvera nuk solli asnjërin prej objektivave që hodhën në letër në shkurt, kur kujtonin se qeveria i kishte ditët e numëruara.

As frymë popullore, as destabilizim politik, as imponim ndaj qeverisë për t'u dorëzuar, as simpati e përkrahje nga ndërkombëtarët. Përkundrazi, nga dritaret e opozitës hyn vetëm ajër i akullt, i ardhur nga të gjitha zyrtat që merren me Shqipërinë, këtej dhe andej oqeanit. Ky është bilanci i opozitës tani që zgjedhjet lokale kanë trokitur në derë dhe kur zakonisht ngjarjet ecin më shpejt se zakonisht. Për momentin Lulzim Basha vijon t'u përmbahet dy fjalive të artikuluarra në Vlorë në 11 prill. Të shohim edhe sa kohë do të rezistojë.../Javanews.al

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT MË VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Opinioni *i* Ditës

Emocioni i Notre Dame

Nga Dominique Moisi

(vijon nga faqja 1)

... i kujtesës së tyre individuale dhe kolektive. Emocionet e atyre që qenë dëshmitarë të zjarrit në Paris më 15 dhe 16 prill janë bërë me jehonë në të gjithë botën. Le të shpresojmë që ky shpërthim global i ndjeshmërisë në përgjigje të një tragjedie do të ketë efekte pozitive të qëndrueshme, në Francë dhe më gjerë.

Që nga dy sulmet terroriste që përgjakën kryeqytetin francez në vitin 2015 nuk kisha marrë kaq shumë mesazhe keqardhjeje (dhe kërkesa për intervista), siç ndodhi pasi ra zjarri. Ato vinin nga Australia, Japonia, Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar, Holanda dhe shumë vende të tjera.

Zjarri nxiti, gjithashtu, një fluks të menjëhershëm dhe bujar kontributesh financiare për të ndihmuar në rindërtimin e katedrales, jo vetëm nga Franca, ku qindra miliona euro u premtuan brenda vetëm një dite, por nga e gjithë bota. Në Amerikë veçanti, donatorët e pasur reagoan shpejt në mbështetje të katedrales që i kishte rënë kambanave të saj për viktimat e sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001.

Disa mund të tronditen disi nga një shpërthim i tillë emocionesh pozitive, sikur fati i një ndërtese 800-vjeçare të ishte më i rëndësishëm sesa mbijetesja e planetit, jetët e miliona refugjatëve, apo gjendja e të varfërve në botë. Ne duket se e kemi më të lehtë të kujdesemi për ruajtjen e trashëgimisë së kaluarës sesa të shpëtojmë të ardhmen tonë. Ne më mirë mbrojmë ndërtesat historike sesa qeniet njerëzore.

E megjithatë, i kuptoj dhe i ndaj emocionet e shkaktuara nga zjarri, si dhe ndjenjën e përgjegjësisë për lënien e këtij monumenti të paprekur për brezat e ardhshëm. Notre Dame ishte ndërtesë që njihje nga gjyshërit e mi dhe dua që "ajo" të vazhdojë të jetë kështu edhe për nipërit e mbesat e mi. Nëse detyra jonë kolektive si qenie njerëzore është të riparojmë dhe përmirësojmë mjedisin tonë sa më shumë që mundemi në kohën tonë shumë të shkurtër në këtë planet, atëherë fati i katedrales është një përparësi natyrore. Dua që historia ta shohë brezin tim si ai që bëri gjithçka ishte e mundur për të rindërtuar Notre Dame, ose ndoshta e bëri atë akoma edhe më të bukur, si një simbol universal i paqes dhe bukurisë.

Unë nuk jam i krishterë. Por, si një parisien, një francez dhe një evropian, për të mos përmendur si një qytetar të botës, më pushtoi një lloj ndjenje e thellë humbjeje kur filloi zjarri, ndërsa ekspertët druheshin se e gjithë katedralja mund të shembej. Duhet të nxitohet të shikojta edhe një herë ndërtesën për të ruajtur një kujtim të saj, para se ajo të shndërrohej në një fushë rrënojash dhe një det hiri. Ndjeva se i



detyrohesha kaq Notre Dame-it, si një pjesë integrale e historisë e madje edhe jetës sime.

Miliona njerëz para meje mund të kenë thënë të njëjtën gjë. Napoleoni u kurorëzua perandor në Notre Dame në dhjetor 1804. Një brez më vonë, gjiganti francez Viktor Hygo e përjetësoi katedralen në romanin e tij "Kurrizjoja i Notre Dame", i cili më vonë u bë film dhe muzikale tepërt të suksesshme. Dhe në gusht të vitit 1944, Charles De Gaulle mori pjesë në një meshe atje për të festuar çlirimin e Parisit gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur qyteti nuk ishte pacifikuar ende plotësisht.

Por pse miliona njerëz në të gjithë botën ndajnë të njëjtat emocione si unë? Bukuria e katedrales sigurisht që është pjesë e arsyes, ashtu si dhe natyra spektakolare e zjarrit që për pak e shkatërroi plotësisht atë. Një mikësia ime, ballkoni i të cilës është me pamje nga Notre Dame në bregun e majtë të Senës, më përshkroi atë që

ajo mund ta quante vetëm "magjepsje me horror". Nuk po digjej Parisi, por zemra e tij emocionale po. Për më tepër, ky zjarr gjigant po transmetohej drejtpërdrejtë në lajmet kryesore. Monumenti më i vizituar në Europë, sipas autoriteteve franceze, ishte gati të shembej. Ishte pikërisht ky element familjariteti që ndihmoi në gjithë atë ndjeshmëri universale për fatin e katedrales.

Kjo më kujtoi një debat që pata dhjetë vjet më parë me filozofen amerikane Martha Nussbaum, e cila përshkroi një eksperiment me minj. Ajo tha vetëm kur një mi që ata "e njihnin" i nënshtrohej dhimbjes, minjtë e tjerë tregonin interes për vuajtjen e atij miu. Pjesën tjetër të kohës, ata ishin totalisht indiferentë.

Kjo ndjeshmëri e ka shndërruar diçka që nisi si një film horror në një film që të krijon një ndjesi të mirë, të paktën tani për tani. Presidenti francez Emmanuel Macron e ndjeu emocionin e

gjerë dhe e përdori atë me mjeshhtëri duke bërë thirrje për unitet kombëtar pas shuarjes së zjarrit. Gjatë muajve të fundit, Franca ka përjetuar demonstrata dhe shpërthime dhune çdo fundjavë dhe vendi kurrë nuk ka qenë kaq i polarizuar kohët e fundit. Por Macron papritur kishte një argument të fuqishëm në dispozicion të tij: një tragjedi e tillë bën thirrje për kapërcim të ndarjeve të vogla, bujari dhe përgjegjësi kolektive.

Emocionet pozitive që lindin pas një ngjarjeje të tillë zakonisht janë të forta dhe jetëshkurtër dhe këtë herë ndoshta nuk do të jetë ndryshe. Vërtetë, drama e Notre Dame dhe përgjigja e aftë e Macron ndaj saj, i kanë dhënë presidentit francez një pushim tepër të nevojshëm para zgjedhjeve të ardhshme të Parlamentit Europian. Por, siç thoshte ish-kryeministri britanik Harold Wilson, një javë është kohë shumë e gjatë në politikë. Dhe zgjedhjet europiane janë ende një muaj larg.

Project Syndicate

HOROSKOPI

DASHI

Të lindurit e kësaj shenje do të lodhen nga eventet e kësaj dite. Ka shumë gjasa që të shpenzoni orë të tëra duke zgjidhur disa probleme. Gjithashtu, ekziston mundësia që të jeni subjekti i një informacioni të gjerë. Në mbërnie mund të përballemi me konflikte të vogla.

DEMI

Mund të zhvilloni disa take me mjaft produktive. Demët e marta ka gjasa të rrisin ndjeshëm të ardhurat e tyre. Kjo mund të ndodhë ose me mbështetjen e të afërme ose me të miqve. Në mbërnie është shumë e rëndësishme të mendohet thellësisht për një çështje që ju ka munduar gjatë ditës.

BINJAKET

Binjakët më 25 prill nuk do të kenë mundësi të arrijnë të gjitha synimet e tyre. Disa situata mund t'ju dalin jashtë kontrollit. Sa i përket marrëdhënieve personale, do të kenë fat. Mos harroni të tregoheni të vëmendshëm dhe të përdorni komplimentet në momentin e duhur.

GAFORJA

Gaforret nuk do të tregojnë zgjuarsni në marrëdhëniet personale. Ka mundësi që dikush që pret të shfaqni interes ndaj tij/saj, do të ndihet i/e mërziut për shkak të sjelljes suaj. Nëse ju duhet të bëni një zgjedhje mes miqësisë dhe karrierës, mendoni me zemër.

LUANI

Luanët do të kalojnë një të enjte joproduktive. Arsyja për këtë mund të jetë shëndeti ose mungesa e dëshirës për të dalë fitues. Është e rëndësishme të degjoni këshillat e të afërme tuaj për mënyrat sesi mund të ndiheni më mirë.

VIRGJERESHA

Disa persona të kësaj shenje do të arrijnë të dalin nga disa vështirësi financiare. Ka gjasa të shlyeni një borxh afat-gjatë ose mund t'ju vijë para nga një burim i papritur. Në jetën tuaj private nuk do të ketë arsye të veçantë për entuziazëm apo irritim.

PESHORJA

Disa Peshore do të bien në konflikt me ndërgjegjen e tyre. Për të ndaluar një çrregullim emocional do të ishte mirë të analizoni pasojat e çdo hapi që do të ndërmerri. Në mbërnie do të kaloni momente argëtuese nën praninë e miqve ose nën praninë e partnerit/partneres suaj.

AKREPI

Akrepët do të ndihen në siklet nga dhurata apo komplimenti që mund t'i bëjnë dikush. Përveç kësaj, nuk do të kenë momente të tjera të ngjashme dhe gjithçka do të jetë si çdo ditë tjetër. Duhet t'i kushtoni vëmendje të veçantë shëndetit të një prej të afërmeve tuaj.

SHIGJETARI

Kjo ditë as do t'ju kënaqë as do t'ju trishtojë. Ngjarjet do të zhvillohen normalisht dhe do t'ju japin ndjenjën e besimit së gjithçka është nën kontroll. Në mbërnie rekomandohet të shihni një film aventurë ose të lexoni një libër aksion nga një autor i famshëm.

BRICJAPI

Bricjapët duhet të kontrollojnë gjithçka që ndodh rreth jush. Ka gjasa të përfetoni një eksperiencë të qutiditshme, konfuzie ose dramatikë. Përpara se të flisni kontrolloni çdo fjalë. Shumë gjëra mund të mos duken ashtu siç janë.

UJORI

Disa Ujorë do të jenë në kërkim të famës, por është e rëndësishme që të mos e tepëroni. Ka gjasa që të lëndoni dikë me veprimet tuaja. Familjarët mund të kërkojnë vëmendjen tuaj të veçantë. Një prej prindërve mund të shfaqë probleme shëndetësore.

PESHQIT

Disa persona të kësaj shenje mund ta kalojnë këtë të enjte qetësisht. Fokus i yt do të jenë çështjet profesionale, biznesi apo karriera. Ata që janë në kërkim të një pune të mirë, duhet të kërkojnë ndihmë nga miqtë e ngushtë. Megjithatë mos besoni verbërisht në gjithçka thuhet.



Opinioni u kundërvihet rëndë

"Lavdi Musolinit", ultrasit fashistë të Lacios tronditin Italinë

Pak orë përpara sfidës gjysmëfinale të Kupës së Italisë mes Milanit dhe Lacios, tifozët nga kryeqyteti italian kishin nisur të mbërrinin në Milano për të përkratur ekipin e tyre në sfidën e dytë, teksa rezultati

i 90 minutave të para të para që kanë përfunduar 0-0, u kanë thënë besim tifozëve se mund t'ia dalin mbanë për të arritur në finale. Në "San Siro" ishin të pranishëm rreth 4 mijë tifozë, por ajo që ka befusuar dhe tronditur

krejt opinionin në Itali ka qenë një banderolë e shpalosur në qytetin e Milanos nga një prej grupeve të "Curva Nord" të Lacios, "Irriducibili", të cilët njihen për bindjet e tyre të ekstremitetit të djathtë. Të deklaruar

hapur si fashistë, "Irriducibili" nuk kanë ngurruar që të shpalosin mesazhin "Onore a Benito Mussolini", kushtuar ish-diktatorit famëkeq italian, ndërsa të grumbulluar në rrugën "Buenos Aires" të Milanos, fare pranë sheshit qendror të qytetit, kanë hedhur edhe kor fashist, duke kërkuar që të provokojnë tifozët e Milanit. "Curva Nord" e Lacios është e binjakëzuar me "Curva Nord" e Interit.

Verilindorët thyejnë kampionët me rezultatin 2-1, Luftëtari-Tirana mbyllet 0-0



Jeton Selimi

Kukësi mposht Skënderbeun, paqe e bardhë në Gjirokastrë

Kupa e Shqipërisë luan gjysmëfinalet e para

Kukësi mposhti Skënderbeun me rezultatin 2-1 në Kamëz, në sfidën e parë gjysmëfinale të Kupës së Shqipërisë mes të dy skuadrave, që shikojnë këtë kompeticion si mënyrën për të shpëtuar sezonin. Sfida nisi mjaft e luftuar në Kamëz, por në minutën e 20 ishte Kukësi që kaloi në avantazh, teksa Rroca lëshoi një top të gjatë pas shpinës së mbrojtjes korçare dhe atje Reginaldo e mori mirë dhe e gjuajti në rrjetin e portës së Dajsinanit. Me këtë rezultat u mbyll pjesa e parë, ndërsa në fillim të pjesës së dytë ishte Vasil Shkurtaç që dyfishoi avantazhin, pasi i shpëtoi kurthit të pozicionit jashtë loje të mbrojtjes korçare dhe dribloi Dajsinanin, për të çuar topin në rrjetë. Ky gol i dytë zgjoi korçarët, që vetëm 5 minuta më vonë shfrytëzuan një gabim të mbrojtjes kuksiane, për të rihapur takimin, me golin



KUPA E SHQIPËRISË	
GJYSMËFINALET	
DJE	Kukësi - Skënderbeu 2-1
	Luftëtari - Tirana 0-0
8 MAJ	Skënderbeu - Kukësi
	Tirana - Luftëtari

e shënuar nga sulmuesi vlonjat, Dejvi Bregu. Me pas korçarët shtuan presionin dhe krijuan disa mundësi të mira për të barazuar, por nuk u treguan aspak të kthjellët në pasimin e fundit, duke gabuar thuajse gjithmonë në zonën e rreptësisë. Kukësi ka hedhur kështu hapin e parë drejt kualifi-

kimit, por pikërisht goli i Bregut mban në lojë Skënderbeun, që do të tentojnë të përmbysë gjithçka në sfidën e kthimit, në 8 maj, në qytetin e Korçës. Nuk pati fitues në sfidën tjetër gjysmëfinale, atë mes Luftëtarit dhe Tiranës në Gjirokastrë, dy skuadra të cilat e shtynë çështjen e kualifikimit për ta vendosur në ndeshjen e kthimit në kryeqytet, më 8 maj. Të dyja ekipet ishin vendosur mirë në fushë dhe luajtën me shumë kujdes, duke bërë që tifozët të shikonin një ndeshje me pak raste për shënim, ndërsa golat duket se janë lënë për ndeshjen e fundjavës për kampionat.

FLET PORTUGEZI

Murinjo: Nuk kthehem më në Angli, Interi një familje

Hoze Murinjo është rikthyer të flasë për një skuadër, me të cilën portugezi ka një marrëdhënie speciale. Bëhet fjalë për Interin, ekipi ku luiztani fitoi tripletën e famshme dhe solli një gëzim të madh për popullin zikaltër. Ndërkohë, ndër të tjera tekniku shtoi se nuk ka ndër mend të kthehet në Premier League pas aventurës së fundit me Manchester Junajtid. "Interi është një familje e madhe, më ka bërë të ndihem i lumtur çdo ditë. Lidhja me tifozët vjen si rezultat i sjellje së skuadrës në fushë, nëse fitohet, atëherë të dyja palët janë të lumtura. Në Londër ka akoma interes të më ndalojnë në rrugë dhe më përgëzojnë. Italia ishte habitati im natyral, pasi është një vend që jeton me futbollin 24 orë. Etapa e radhës nuk do të jetë Premier League, mendoj se këto muaj pa punuar kanë qenë të vlefshëm", tha Murinjo.



TRAJNERI I REAL MADRIDIT

Zidan shpërthen: Ne kemi 33 tituj, sa ka Barcelona?

Reali i Madridit do të luajë sfidë shumë të vështirë ndaj Getafes në transfertë. Zidan ka dalë në konferencën e zakonshme për shtyp dhe ka analizuar skuadrën e tij. Gazetarët nga ana e tyre nuk mund të mos e ngacmonin francezin, për sezonin e shkëlqyer që po bën Barcelona, e cila po shkon për tripletën. Gjithashtu, ky do të jetë titulli i 26-të për katalanasit, që kanë 7 tituj më pak se madrilënët. Këtu Zidani ka humbur ftohtësinë e tij dhe ka folur disi me tifozëllëk. "Ne kemi 33 kampionate. Barcelona sa ka? Janë duke bërë një sezon shumë të mirë dhe këtë jemi detyruar ta pranojmë, por nëse doni të flasim për shifra, Reali ka më shumë kampionate. Nuk e them të mbroj skuadrën time. Por, sepse më thonë që Barcelona po bën shumë mirë vitet e fundit. Shumë mirë, sa tituj kanë?", ka thënë Zidani.




Drejtori i "Corriere Dello Sport"

Zazaroni: Hysaj s'është një kampion dhe s'vlen 40 milionë euro

Ivan Zazaroni, drejtori i gazetës sportive italiane "Corriere Dello Sport" ka bërë disa komente për mbrojtësin e përfaqësues shqiptar, Elseid Hysaj. Edhe ai, si shumë të tjerë, mendon se mbrojtësi kuqezi nuk di të funksionojë në maksimumin jashtë sistemit të lojës së Mauricio Sarrit, duke treguar limitet që ka. "Ançeloti ka zhvlerësuar shumë lojtarë? Elseid Hysaj e Mario Rui kanë treguar limitet e tyre jashtë kontekstit të Mauricio Sarrit, por nuk kanë qenë kurë kampionë, edhe pse loja i bënte që të shfaqnin më shumë në fushë", tha ai në një intervistë për "Marte Sport Live". Me pas, një koment edhe më i rëndë sa i përket vlerësimit të mbrojtësit shqiptar, për të cilin një vit më parë Napoli bëri luftë me Çelsin që të mos e linte të largohej. "Hysaj nuk vlen 40 milionë euro, është ekzagjerim", tha Zazaroni.



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Mund të jetë kursimi.
5. Ylli i Nostradamus.
8. Tamam pa kufij.
11. Ross këngëtare.
13. I lashtë.
15. Është Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
19. Kufijtë e lëvizjes
20. I ka tek plepi.
21. Paguhen për shërbim.
23. Fillojnë lejen.
24. Kufizojnë trotualet.
25. Bëjnë karrierë në parti.
27. Thahet me bonifikim.
28. Mund të jetë unik një i tillë.
29. Preka komik shkordran.
31. Fund dhjetori.
32. Fillojnë aksionin.
33. Ente Operative Tiranë

34. Agjenci Ajrore Durrës.
36. Një pjesë e dimensioneve.
39. Është përfaqësuesja e Adriam Mutu.
41. Kalimi në ekstreme.
42. Është e re pas Krishtit.
43. Shkruhet për të mos vazhduar më.
44. Si i gjithë.
47. Kush e thotë lutet.
48. Kufij elementi.
49. Ishte nryja që preu Aleksandri i Madh.
50. Një pjesë e titanëve.
51. Mund të jetë kundërmuese.
52. Pak titanike.

VERTIKAL

1. Si i përshtatëshëm.
2. Mund të jenë fetare.
3. Ai i kuq e ka një huq.
4. Pak analogji.
6. Është metri i rrobaqepësit.
7. Në hyrje të oazit.
8. Arte pa re.
9. Arthur që qe dramaturg.
10. Janë boshte.
12. Michelangelo regjisor.
14. Mund të bëjë stil të lirë.
16. Ishin monedhe të Tobias.
17. Është bas me katër tela.
18. Pak efikasitet.
22. Është marrëveshje me nota.
25. Ishte babai i Aklit.
26. Fillojnë nazet.
27. Në krye të kuadrove.
29. Është faqe muri.
30. Një apendisit i menjëhershëm.
35. Kurosawa që qe regjisor.
36. Vriten nga espada.
37. Është shtet aziatik.
38. Edouard piktor.
40. Një transporti është kamioni.
45. Uni i Freud.
46. Një cigan.
47. Fundi i një samurai.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL

1. Fillojnë panikun.
3. Gibson aktor.
5. Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
9. Mund të jetë trofe.
11. Janë vendet si Katari
14. Maureen që qe aktore.
16. Janë kundërmuese.
17. Mund të fitojnë etapa.
20. Ushtojnë nga "ola".
22. Një thirrje
26. Janë ministritë.
27. Një rrugë në Paris.
28. Markë cigareje.
29. Është ngjinja.
32. Ricciarelli soprano.
33. Fillojnë sete.


VERTIKAL

1. Një votë në favor.
2. Filozofi me eksperimentin e gomarit.
3. Në hyrje makinës.
4. Fillojnë lehtë.
5. Irlanda në Dublin.
6. Është edhe ajo e historisë.
7. Një pjesë e gamiljeve
8. Notat pa kufij.
9. Ishin komitë.
10. Ka kryeqytet Islamabad.
12. Don... i Interpretuar nga Terence
13. Mbyllin aktet.
15. Janë përmasa.
18. Gjysma e lutjes.
19. Castellito aktor.
20. Inicilat e Dalí, piktor.
21. Tanita këngëtare.
23. Është trysni
24. Në hyrje të Europës.
25. Janë rrobat për t'u larë.
30. Bën mëza.
31. Moreau aktore.
32. Janë thika.
39. Një pjesë e satelitit.
40. Janë teke në sende.
41. Pak marramendëse.
42. I ka tek zdapi.
45. Inicialet e Nolte-s.




6. Është edhe ajo e historisë.
7. Një pjesë e gamiljeve
8. Notat pa kufij.
9. Ishin komitë.
10. Ka kryeqytet Islamabad.
12. Don... i Interpretuar nga Terence
13. Mbyllin aktet.
15. Janë përmasa.
18. Gjysma e lutjes.
19. Castellito aktor.
20. Inicilat e Dalí, piktor.
21. Tanita këngëtare.
23. Është trysni
24. Në hyrje të Europës.
25. Janë rrobat për t'u larë.
30. Bën mëza.
31. Moreau aktore.
32. Janë thika.
39. Një pjesë e satelitit.
40. Janë teke në sende.
41. Pak marramendëse.
42. I ka tek zdapi.
45. Inicialet e Nolte-s.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR

ARMAND LINDA
 VAJIM VEKLE
 ADEEN LAKE OAZE
 TAKMILITANTET
 RAPIRAMTIDALEL
 AFINERITTELEL
 FANATIKETHTHI
 DEANARAEHERONJ
 EMARIANAPINETA
 ETERETIKETA
 KATARAKTITATIM
 ADAMIREFORMAT
 REKORDMENELAU
 SERTPEKINM
 EROSKANONAZHI
 NTRPOLUMEKATA
 EKRIIMNANATIM
 EKRIIMNANATIM
 EMATERIALITLIGU
 INATIRUMIOAZ
 LEGLJENIUNUNA
 ETEALTAARETIT

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

SUDOKU

	5				2			
1			3		8			9
2				6				4
			7					
	6		8			7		
7	8	4						1
				2		6		
	3			1				
	8							

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	8	7	2	5	9	6	1	3
2	5	3	6	1	7	4	9	8
1	6	9	8	3	4	7	2	5
6	9	5	7	2	1	8	3	4
3	2	8	9	4	6	5	7	1
7	1	4	3	8	5	9	6	2
8	7	2	4	9	3	1	5	6
5	3	6	1	7	8	2	4	9
9	4	1	5	6	2	3	8	7

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Kam filluar dietë. Ndalova dhe pijen, dhe në dy javë kam humbur 14 ditë.



- Asnjëherë mos e shtyj për nesër atë që ju mund të bëni pasnesër.

- Ndërsa përpiqemi për t'u mësuar fëmijëve tanë gjithçka për jetën, fëmijët tanë na mësojnë se çfarë është jeta.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



Thënie të mençura

- Unë e dua njerëzimin. Njerëzit nuk mund ti duroj.
- Nëse jeni duke kërkur për një mik, do të zbuloni se është e vështirë për të gjetur. Nëse je i gatshëm të jesh mik, do t'i gjeni ata kudo.
- Shëmтия është superior ndaj bukurisë, sepse ajo zgjat më shumë.
- Martesa është mrekullia që transformon puthjen nga kënaqësi në detyrë.

